



GYKATA SPECIALE NË HAGË KA DËNUAR KATËR ISH-KRERËT
E UÇK-SË ME 81 VJET BURGIM

TURPI I SPECIALES DHE DREJTËSISË NDËRKOMBËTARE. BETEJA VAZHDON



Gjykata Speciale në Hagë i shpalli katër ish-krerët e UÇK-së fajtorë për katër akuza për krime lufte, ndërsa i liroi nga akuzat për krime kundër njerëzimit. Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me

nga 25 vjet burgim, ndërsa Kadri Veseli me 18 vjet dhe Rexhep Selimi me 13 vjet. Aktgjykimi është i shkallës së parë, ndërsa avokatët mbrojtës kanë paralajmëruar se do ta apelojnë. Ky aktgjykim ishte

një ditë e rëndë për Kosovën, duke sjellë dhimbje dhe zhgënjim të thellë te qytetarët, të cilët theksuan se kjo ishte edhe një ditë turpi për drejtësinë ndërkombëtare

AKTUALE



KANADAJA FTOHET TË BËHET
'ANËTARJA E PARË E ASOCIUAR'
E BE-së **F. 2**

MICS 2025: PËRPARIM PËR FËMIJËT
NË KOSOVË, POR PABARAZITË
MBETEN TË THEKSUARA **F. 7**

SHBA-JA KUFIZON VIZAT PËR
ZYRTARË TË AFRIKËS SË JUGUT,
I AKUZON PËR DISKRIMINIM
NDAJ TË BARDHËVE **F. 2**

EKONOMI



KONSUMI I ENERGJISË NË KOSOVË
U RRIJT 21.2 PËR QIND NË KORRIK
KRAHASUAR ME MUAJIN E NJËJTË
TË VITIT TË KALUAR **F. 8**

SPORT



DERBI GJILANI - PRISHTINA, TË
PREMTEN MBRËMA **F. 10**

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ZELENSKY: RUSIA E KA SHËNJESTRUAR DY HERË AEROPLANIN TIM NË MOLDAVI

KIEV, 16 SHTATOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka deklaruar se Rusia ka shënjestruar dy herë aeroplanin presidencial me të cilin ai udhëtonte nëpër hapësirën ajrore të Moldavisë gjatë javëve të fundit. Në një intervistë për CBS, Zelensky tha se një nga incidentet ndodhi gjatë udhëtimit të tij drejt Norvegjisë, ndërsa një tjetër gjatë kthimit në Ukrainë. “Aeroplani im presidencial ishte në Moldavi dhe për këtë arsye ata sulmuan Moldavinë. Kur u kthyem në shtëpi, përsëri përmes Kishinait, ata bënë të njëjtën gjë”, deklaroi Zelensky. Kryeministri norvegjez Jonas Gahr Støre kishte bërë me dije më herët se aeroplani me të cilin

udhëtonte Zelensky ishte “pothuajse goditur” nga një dron në hapësirën ajrore moldave, teksa presidenti ukrainas po nisej drejt Oslos më 9 shtator. “Ky është realiteti në të cilin ai jeton”, kishte deklaruar Støre, transmeton Telegrafi. Zelensky tha se një ose dy dronë kishin hyrë gjithashtu në hapësirën ajrore të Moldavisë gjatë kthimit të tij drejt Ukrainës, disa ditë pas vizitës në Norvegji. Zyrtarët ukrainas deklaruan më vonë se të gjithë anëtarët e delegacionit presidencial ishin të sigurt. Në atë kohë, megjithatë, nuk ishte e qartë nëse incidenti ishte i qëllimshëm apo jo. Zelensky e ka lidhur ngjarjen me



atë që ai e përshkruan si një strategji ruse për të frikësuar liderët e huaj dhe për të ushtruar presion përmes

kërcënimeve ndaj tyre. Deklaratat e presidentit ukrainas vijnë në një periudhë kur incidentet me dronë dhe

shkeljet e hapësirës ajrore në Evropën Lindore kanë shtuar shqetësimet për sigurinë rajonale.

KANADAJA FTOHET TË BËHET ‘ANËTARJA E PARË E ASOCIUAR’ E BE-së

BRUKSEL, 16 SHTATOR - Bashkimi Evropian ka hapur një kapitull të ri në marrëdhëniet me Kanadanë, pasi presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, njoftoi se Ottawa është ftuar të bëhet “anëtar i parë i asociuar” i BE-së. Propozimi krijon një formë të re bashkëpunimi politik dhe ekonomik, ndërsa detajet mbi të drejtat dhe detyrimet e këtij statusi ende nuk janë përcaktuar. Von der Leyen e bëri njoftimin të mërkurën gjatë fjalimit të saj për gjendjen e Bashkimit Evropian 2026, në Strasburg, ku i pranishëm ishte edhe kryeministri kanadez, Mark Carney. “Dua të punoj me ju për t’i hapur derën Kanadasë që të bëhet anëtar i parë i asociuar i Bashkimit Evropian”, tha von der Leyen. Ajo theksoi se BE-ja dhe Kanada ndajnë vlera dhe interesa të përbashkëta. “Ne ndajmë një oqean, një grup vlerash dhe një mënyrë të përbashkët për ta parë botën. Tani do të ndërtojmë së bashku edhe të ardhmen tonë”, deklaroi ajo. “Anëtarësimi i asociuar” nuk është një kategori ekzistuese standarde e anëtarësimit në BE dhe, për këtë arsye, mbeten ende shumë pyetje rreth mënyrës se si do të funksiononte ai. Një nga çështjet kryesore është



nëse Kanada do të kishte ndonjë rol në proceset vendimmarrëse të institucioneve evropiane apo të drejtë vote. Vende si Norvegjia dhe Zvicra kanë marrëdhënie shumë të ngushta me BE-në dhe qasje në pjesë të tregut të përbashkët, por nuk kanë të drejtë vote mbi legjislacionin e BE-së. Propozimi i ri vjen në një moment kur Kanada po kërkon marrëdhënie më të ngushta me Evropën. Kryeministri Mark Carney ka folur më herët për krijimin e një “aleance unike” me BE-në. Von der Leyen propozoi gjithashtu një partneritet të ri me Otavën që do të shtrihej përtej tregtisë. Ai mund të përfshijë teknologjinë,

inteligjencën artificiale, mbrojtjen, energjinë, mineralet kritike dhe projekte të përbashkëta në Arktik. “Ne do të kalojmë nga CETA drejt një Aleance për të Ardhmen, për të krijuar një hapësirë të përbashkët të prosperitetit dhe sigurisë ekonomike”, tha ajo, duke iu referuar marrëveshjes së tregtisë së lirë BE-Kanada. Bashkëpunimi pritet të diskutohet më tej në samitin BE-Kanada që do të mbahet në Montreal më 29 dhe 30 tetor. Komisioni Evropian e ka përshkruar Kanadanë si një partner strategjik dhe të afërt të BE-së. Afrimi nuk nis nga zero. Kanada tashmë është e asociuar me Pillar

II të programit Horizon Europe, duke u dhënë studiuesve dhe organizatave kanadeze mundësinë të marrin pjesë në projekte të programit në kushte të barabarta me partnerët e BE-së. Sipas burimeve të cituara nga Euronews, Ottawa dhe Brukseli po diskutojnë gjithashtu pjesëmarrjen kanadeze në programe të tjera evropiane, përfshirë Erasmus+, financimet e kërkimit përmes Horizon Europe dhe njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale. Kjo e bën propozimin e ri një hap potencialisht më të gjerë se marrëveshjet ekzistuese sektoriale. Njoftimi vjen në një periudhë kur

marrëdhëniet e Kanadasë me Shtetet e Bashkuara janë përkeqësuar ndjeshëm për shkak të mosmarrëveshjeve tregtare dhe tarifave amerikane. Vizita e Carney-t në Evropë dhe pjesëmarrja e tij në fjalimin e von der Leyen vijnë në këtë kontekst. Për BE-në, afrimi me Kanadanë lidhet jo vetëm me tregtinë, por edhe me sigurinë ekonomike, mbrojtjen, burimet kritike, teknologjinë dhe Arktikun, një rajon me rëndësi në rritje strategjike. “Evropa dhe Kanada besojnë në demokraci. Pushteti nuk u përket më të fortëve, më të pasurve apo atyre që bërtasin më shumë, por të gjithëve ne”, tha von der Leyen. Megjithatë, propozimi është ende në fazën fillestare. Nuk është përcaktuar ende se çfarë kompetencash konkrete do të kishte një “anëtar i asociuar”, çfarë detyrimesh do të merrte përsipër Kanada dhe deri ku do të shtrihej përfshirja e saj në institucionet e BE-së. Nëse modeli konkretizohet, Kanada do të bëhej partneri i parë që merr këtë status të ri, duke krijuar një format marrëdhëniesh që mund të shërbejë edhe si precedent për mënyrën se si BE-ja bashkëpunon me shtete të tjera jashtë Unionit.

ShBA-ja kufizon vizat për zyrtarë të Afrikës së Jugut, i akuzon për diskriminim ndaj të bardhëve

UASHINGTON, 16 SHTATOR - Administrata Trump ka vendosur kufizime për vizat ndaj personave nga Afrika e Jugut, të cilët Uashingtoni i akuzon për nxitje të diskriminimit racor dhe të politikave që, sipas ShBA-së,

prekin komunitetin e bardhë afrikaner. Masa shënon një tjetër përshkallëzim të tensioneve mes dy vendeve. Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, njoftoi se kufizimet do të zbatohen ndaj

personave që, sipas Washingtonit, promovojnë “diskriminim të bazuar në racë”, nxisin dhunë ose mundësojnë konfiskimin e tokës pa kompensim në Afrikën e Jugut. “Qeveria e Afrikës së Jugut nuk i

ka adresuar në mënyrë të mjaftueshme shqetësimet e paraqitura më herët”, tha Rubio në deklaraten ku njoftoi masat. Ai nuk bëri publike menjëherë emrat e personave që do të preken nga kufizimet.





GJYKATA SPECIALE NË HAGË KA DËNUAR KATËR ISH-KRERËT E UÇK-SË ME 81 VJET BURGIM

TURPI I SPECIALES DHE DREJTËSISË NDËRKOMBËTARE. BETEJA VAZHDON

Gjykata Speciale në Hagë i shpalli katër ish-krerët e UÇK-së fajtorë për katër akuza për krime lufte, ndërsa i liroi nga akuzat për krime kundër njerëzimit. Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, ndërsa Kadri Veseli me 18 vjet dhe Rexhep Selimi me 13 vjet. Aktgjykimi është i shkallës së parë, ndërsa avokatët mbrojtës kanë paralajmëruar se do ta apelojnë. Ky aktgjykim ishte një ditë e rëndë për Kosovën, duke sjellë dhimbje dhe zhgënjim të thellë te qytetarët, të cilët theksuan se kjo ishte edhe një ditë turpi për drejtësinë ndërkombëtare

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Ish-krerët Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, janë dënuar të mërkurën nga Gjykata Speciale në Hagë. Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burgim, Kadri Veseli iu shqiptua dënimi me 18 vjet burgim, ndërsa Rexhep Selimi u dënua me 13 vjet burgim. Kryetari i trupit gjykues, Charles Smith, shpalli aktgjykimin dënues për të katër të akuzuarit. Trupi gjykues konstatoi se “të katër të akuzuarit kishin të njëjtin qëndrim se elementë kyçë i mjeteve dhe strategjisë për realizimin e qëllimeve ishin shënjestrimi, eliminimi ose neutralizimi i disa personave të cilat konsideroheshin si pengesë”. “Shënjestrimi i kundërshtarëve mori formën e vrasjeve, ndalimit, arrestimit, keqtrajtimit fizik dhe psikologjik dhe forma të tjera të keqtrajtimit”, tha Smith. Ai tha se

ish-krerët e UÇK-së përdorën “luftë speciale” ndaj atyre që tha se perceptoheshin si kundërshtarë. Smithi tha se Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi dhanë “kontribut të qenësishëm në zbatimin e qëllimit kriminal të përbashkët”. Pasi shqiptoi dënimet, Smithi e mbylli seancën. Pala mbrojtëse ka mundësi ta apelojë vendimin në shkallët e tjera të gjykatës. Vendimi për katër ish-drejtesit e UÇK-së u prit në fund të një gjykimi që ka shkuar shumë përtej kuadrit ligjor. Në vendin ku ish-guerillasit mbeten heronj, kjo gjykatë speciale rihapi plagët e luftës. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi u arrestuan dhe u dërguan për në paraburgimin e Gjykatës Speciale në Hagë më 4 dhe 5 nëntor 2020. Që atëherë ata qëndruan në paraburgim dhe para një procesi të stërzgatur gjykimi, të akuzuar për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit që pretendohet të jenë kryer gjatë periudhës së luftës, periudhë për të cilën ata thanë se

ndihën më së shumti krenarë dhe janë deklaruar të pafajshëm.

Avokati i Thaçit paralajmëron apel: “Ditë e errët për drejtësinë ndërkombëtare”

Avokati i Hashim Thaçit, Pierre-Richard Prosper, e ka cilësuar aktgjykimin ndaj klientit të tij si një “tallje me drejtësinë” dhe ka paralajmëruar se mbrojtja do ta apelojë vendimin. Prosper pretendoi se rezultati i procesit ishte i paracaktuar dhe akuzoi Dhomat e Specializuara se po “rishkruajnë historinë”, duke e paraqitur UÇK-në si një strukturë të organizuar dhe duke ia atribuar, sipas tij, përgjegjësinë Thaçit. “Kjo është një ditë e errët për drejtësinë ndërkombëtare dhe fundi i tribunaleve”, tha Prosper pas shpalljes së aktgjykimit. Ai tha se ka biseduar me Thaçin dhe se do ta takojë sërish. “Thaçi është i gatshëm të vazhdojë të

luftojë për veten dhe për popullin e Kosovës”, tha Prosper. Sipas tij, shpresa e mbrojtjes është që aktgjykimi të rrëzohet në apel, ndonëse paralajmëroi se procesi mund të zgjasë me vite. Prosper bëri thirrje, gjithashtu, që Kuvendi i Kosovës ta shqyrtojë raportin me Dhomat e Specializuara, duke thënë se Kosova duhet të marrë “një vendim sovran që është në interesin më të mirë të vendit”. “Nëse do të isha deputet, që nga nesër do ta tërhiqja mbështetjen për këtë gjykatë”, tha Prosper. Apelimin e aktgjykimit e paralajmëruan edhe avokatët e të dënuarve të tjerë.

Avokati i Kadri Veselit: Ka pasur mungesë të dëshmimeve, do të reagojmë

Avokati i Kadri Veselit, Rodni Dikson, ka deklaruar se mbrojtja do të reagojë pas vendimit të fundit, duke shqyrtuar procedurat që mund të ndërmerren më tej. Ai ka shprehur pakënaqësi me mënyrën se si është trajtuar çështja, duke vlerësuar se gjatë procesit ka pasur mungesë të dëshmive të mjaftueshme. “Ka pasur mungesë të dëshmive dhe ne do të reagojmë për të parë se cilat janë procedurat që duhen ndjekur. Për fat të keq, kjo nuk është një ditë e mirë për Kosovën, për ligjin në përgjithësi”, ka deklaruar avokati.

Ai shtoi se mbrojtja nuk është e kënaqur me mënyrën se si është zhvilluar procesi dhe me dëshmitë e paraqitura. “Nuk jemi të kënaqur me krejt këtë mënyrë se si është trajtuar dhe me dëshmitë që janë paraqitur”, u shpreh ai. Ai tha se do ta shqyrtojnë me shumë kujdes këtë aktgjykim në mënyrë që të përgatitet ankesë dhe të dëshmohej pafajësia e Veselit.

Mbrojtja e Selimit: Jemi shumë të zhgënjyer, do ta rishikojmë vendimin

Mbrojtja e Rexhep Selimit, avokati Jeffrey Roberts, ka folur pas vendimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, me të cilin ai u dënua me 13 vjet burgim. Në një reagim të shkurtër për medie, mbrojtja tha se është shumë e zhgënjyer me vendimin, por theksoi se bëhet fjalë për vendim të shkallës së parë. “Ne jemi shumë të zhgënjyer me vendimin, por është e rëndësishme sepse kjo është shkalla e parë”, tha mbrojtja e Selimit.

OVLUÇK-ja: Turp për drejtësinë ndërkombëtare, liria nuk rishkruhet

Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së (OVLUÇK) ka reaguar pasi Gjykata Speciale në Hagë shpalli fajtorë dhe dënoi ish-

drejtuesit e UÇK-së: Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin dhe Jakup Krasniqin. Përmes një reagimi publik, OVLUÇK-ja ka hedhur poshtë kategorikisht këtë aktgjykim, duke e cilësuar si një goditje të drejtpërdrejtë ndaj luftës çlirimtare dhe sakrificës së popullit të Kosovës. “Asnjë vendim nuk mund ta rishkruajë luftën tonë çlirimtare apo të njollosë ata që luftuan për liri. E vërteta e UÇK-së nuk është çështje interpretimi gjyqësor, është historia e jetuar e një populli që e fitoi shtetin me gjak. Që në fillim e kemi quajtur politike këtë gjykatë dhe procesi na dha të drejtë. Është turp për drejtësinë ndërkombëtare, një njollë që do të mbetet gjatë dhe që tregon se si është trajtuar lufta jonë çlirimtare dhe sakrifica e popullit tonë”, është thënë në reagimin e OVLUÇK-së.

Haxhiu: Dënimet janë goditje e rëndë, fjala e fundit juridike nuk është thënë

Ushtruesja e detyrës së presidentit të Kosovës, Albulena Haxhiu, i ka cilësuar dënimet ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit si “goditje të rëndë” për familjet e tyre dhe “lajm thellësisht tronditës” për Kosovën. Në reagimin pas shpalljes së aktgjykimit, Haxhiu tha se procesi juridik nuk ka përfunduar dhe përmendi mundësinë e ankimit. “Fjala e fundit juridike nuk është thënë. E drejta e ankimit është pjesë e procesit dhe duhet të ushtrohet plotësisht”, shkroi ajo në “Facebook”. Haxhiu tha se lufta e UÇK-së “ishte çlirimtare” dhe se, sipas saj, aktgjykimi nuk duhet të përdoret për t’i relativizuar krimet e kryera nga regjimi serb gjatë luftës në Kosovë. Ajo bëri thirrje për qetësi dhe unitet pas shpalljes së dënimeve. “Sot na duhet qetësi,

dinjitet dhe bashkim. Dhimbja e kësaj dite nuk duhet të na ndajë”, tha Haxhiu.

Kurti: Dënimi, padrejtësi e papranueshme. Aktgjykimi duhet ndryshuar në shkallën e apelit

Kryeministri Albin Kurti ka theksuar se shpallja fajtorë dhe dënimi kaq i rëndë për katër ish-krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, është padrejtësi e papranueshme, ndëshkim i madh dhe i dëmshëm. “Aktgjykimi mund të jetë shqiptuar formalisht në emër të popullit të Kosovës, por kjo formulë e zbrazët nuk duhet ngatërruar me vullnetin e popullit. Ky aktgjykim patjetër duhet ndryshuar dhe korrigjuar në shkallën e apelit dhe atë sa më parë. Në këto momente të vështira, jemi pranë familjeve të ish-krerëve të UÇK-së dhe të gjithë bashkëluftëtarëve çlirimtarë. Siç e dimë, me akuzat në Këshillin e Evropës nga deputeti rus Konstantin Kosaçev dhe ai serb Millosh Alligrudiq filloi gjithçka më 15 prill 2008, por ne duhet të sigurohemi që asgjë nuk përfundoi sot më 16 shtator 2026. Asgjë prej pretendimeve e akuzave të ekzagjeruara e absurde mbi të cilat është arsyetuar ngritja e Dhomave të Specializuara, duke nisur prej Shtëpisë së Verdhë e trafikimit të organeve, nuk ka mundur të ngrihej nga vetë Prokuroria, për shkak të mungesës së provave”, ka thënë Kurti. Për më tepër, ai ka shtuar se aktgjykimi i Dhomave të Specializuara rrëzoi pretendimin më të rëndë që ka mbetur në aktakuzë: se UÇK-ja kishte kryer një sulm të gjerë dhe sistematik kundër një popullsie civile. “Po ashtu, u pa qartë se ky proces nuk ishte gjykim për legjitimitetin apo pastërtinë e luftës së UÇK-së. Gjithashtu nuk u konstatua as



kushti më themelor për krime kundër njerëzimit. Përfundimet dënuese lidhen me akuzat të caktuara për krime lufte, përfshirë torturën e personave të konsideruar bashkëpunëtorë të regjimit serb. Këto janë konstatime të padrejta, por nuk janë përfundimtare dhe do t’i nënshtrohen shqyrtimit në apel. Padrejtësia e akuzave të Prokurorisë është vënë në dukje jo vetëm brenda Kosovës, por edhe jashtë saj. Për karakterin e luftës çlirimtare dhe të UÇK-së dëshmuar para vetë Gjykatës edhe personalitete ndërkombëtare që e kishin njohur konfliktin nga afër. Ata përshkruan UÇK-në si përgjigje ndaj dekadave të shtypjes së shqiptarëve dhe kundërshtuan pretendimin se ajo ishte përgjegjëse për spastrim etnik; gjithashtu ata dëshmuar kundër tezës së një komande të centralizuar që kontrollonte çdo veprim në terren. Këto dëshmi erdhën nga njerëz që panë luftën nga pozita të drejtpërdrejta të përgjegjësisë ndërkombëtare dhe që dëshmuar për karakterin e saj çlirimtar. Kritikën e tyre, të argumentuara në detaje, e nënvizojnë se vendimi i sotëm mbështetet mbi themele

thelbësisht të pasakta, si nga pikëpamja historike, ashtu edhe ajo ligjore. Siç kemi bërë prej fillimit të këtij procesi, qeveria do të vazhdojë, me të gjitha mjetet që i ka në dispozicion, t’i mbështesë të akuzuarit në procesin e apelit, ku presim korrigjimin e plotë të kësaj padrejtësie”, ka deklaruar Kurti. Ai ka thënë se ky aktgjykim nuk mund të lexohet jashtë historisë në të cilën lindi UÇK-ja. “UÇK-ja nuk ishte zgjedhja e një populli që kërkonte luftë, por përgjigja e një populli që, i shtypur dhe i kërcënuar në vetë ekzistencën e tij, kërkonte liri. Populli shqiptar i Kosovës përjetoj heqjen e autonomisë, përjashtimin nga institucionet, dëbimin nga vendet e punës, shkollat dhe universiteti, burgosjet, torturat dhe vrasjet. Më pas erdhën masakrat, djegia e vendbanimeve, dëbimi masiv i qindra mijëra njerëzve nga shtëpitë e tyre dhe gjenocidi. Kjo vuajtje nuk ishte sfondi i rastësishëm i luftës, por realiteti që e bëri qëndresën çështje të mbijetesës së një populli”, është shprehur kryeministri Kurti, duke shtuar se asnjë vuajtje njerëzore nuk duhet mohuar apo zvogëluar. “Por, po aq e padrejtë do të ishte që konstatimet për veprime të caktuara të shndërroheshin në aktakuzë kundër UÇK-së dhe në gjykim të luftës çlirimtare. Ushtria Çlirimtare e Kosovës lindi si përgjigje ndaj shtypjes së një regjimi gjenocidal dhe luftoi për çlirimin e Kosovës. Ky është karakteri politik dhe historik i saj, dhe as arkitektura selektive e një mekanizmi gjyqësor, as një aktgjykim i tij, nuk mund ta zhbëjnë atë. Për një shekull e gjysmë, nga mesi i shekullit XIX e deri te vitet e fundit të shekullit XX, nga instancat e ndryshme por gjithnjë të larta, shtetërore e politike, akademike e pseudo shkencore të Serbisë, janë përpiluar 24 programe për shfarosjen e shqiptarëve”, ka vazhduar Kurti në deklaratën për medie. Ai ka theksuar se Dhomat e Specializuara u krijuan me një mandat të posaçëm, por mandati dhe veprimtaria e tyre e përqendruan drejtësinë vetëm mbi njërin palë të luftës. “Kur në bankën e të akuzuarve gjenden vetëm pjesëtarët e një etnie, ndërsa aparati shtetëror që kreu masakra, dëbime dhe krime gjenocidale mbetet jashtë

juridiksionit, krijohet në mënyrë të pashmangshme pamja e një drejtësie njëetnike. Këtë ndjesi e ka thelluar edhe transparenca e munguar e një procesi, pjesë të rëndësishme të të cilit janë zhvilluar larg syrit dhe vlerësimit të publikut. Një mekanizëm në të cilin përgjegjësia penale përqendrohet vetëm te pjesëtarët e një populli apo bashkësie etnike, ndërsa krimet gjenocidale të palës tjetër mbeten jashtë ndjekjes efektive, krijojnë shqetësime serioze lidhur me barazinë para ligjit, paanshmërinë objektive dhe legjitimitetin e vetë institucionit. Drejtësia selektive mbi baza etnike bie ndesh me parimin themelor se drejtësia jo vetëm duhet të jetë e paanshme, por edhe duhet të perceptohet si e tillë”, është shprehur Kurti. Kryeministri Kurti ka bërë me dije se Kosova do të vazhdojë ta mbështesë Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Rexhep Selimin e Jakup Krasniqin në procedurën e apelit, në mbrojtje të plotë, dinjitoze dhe institucionale. “Kjo është përgjegjësi ndaj qytetarëve tanë dhe besim në të drejtën për ta kundërshtuar një aktgjykim që ende nuk është përfundimtar. Sot u gjykuan akuzat dhe veprime të caktuara; nuk u gjykua dhe nuk mund të dënohet arsyeja pse lindi UÇK-ja e as të njolloset ajo. Sepse kur atdheu nuk duroi më gjakatarë, ai thirri çlirimtarë, dhe emri i tyre ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës”, ka thënë Kurti.

Hamza: Ditë e zezë për Kosovën, vendimi ndaj Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit është kundër popullit të Kosovës

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, është shprehur se aktgjykimi dënues i Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit nga Gjykata Speciale në Hagë është padrejtësi dhe një goditje e rëndë për luftën e UÇK-së, lirinë, pavarësinë dhe shtetin e Kosovës. Duke theksuar që sot në Hagë u godit rëndë rezistenca e popullit të Kosovës, Hamza, në një konferencë për medie, tha se mendje dhe me zemër sot janë me çlirimtarët dhe me familjet e tyre. “Sot është një ditë e rëndë për Kosovën. Një ditë e zezë, por është edhe një ditë e turpit për





drejtësinë ndërkombëtare. Aktgjykimi i sotëm ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit ka sjell dhimbje dhe zhgënjim të thellë tek të gjithë ne. Një dhimbje e zhgënjim që nuk e kemi pritur”, tha Hamza.

Ai paralajmëroi se PDK-ja do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme demokratike dhe ligjore lidhur me këtë proces. “Partia Demokratike e Kosovës do të jetë në përkrahje të luftës së drejtë dhe të pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Do të jetë në përkrahje të plotë të udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme demokratike dhe ligjore që kanë të bëjnë me këto proces”, tha kryetari i PDK-së.

Hamza u shpreh se sot u fye sakrificat e popullit tonë që luftoi për liri, mbijetesë dhe çlirim nga regjimi shtetëror serb që vrau, dëboi dhe terrorizoi shqiptarët e Kosovës. “Vendimi i shqiptuar sot nuk është bërë në emër të popullit të Kosovës. Vendimi i shqiptuar sot është bërë kundër popullit të Kosovës, kundër shtetit të Kosovës. Ne e kemi përcjellë këtë proces me besimin se në fund drejtësia do të mbështetet vetëm në fakte, në prova dhe në përgjegjësi individuale. Por, sot nuk pamë drejtësi”, tha ai.

Hamza u shpreh i indignuar që vendimi për ish-krerët e UÇK-së bazohet në propagandën për luftën e UÇK-së dhe në evidencat rastesh që janë mbyllur nga UNMIK-u dhe EULEX-i në dy dekadat e pas luftës. “Ai vendim mbështetet edhe në pretendime e materiale që i konsiderojmë të fabrikua dhe të ushqyera ndër vite nga aparati shtetëror dhe propaganda e Serbisë për ta kriminalizuar luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. U dënuan, ndër të tjera, edhe pse ushtarët e UÇK-së kanë ndaluar dhe legjitimuar serbë përreth zonave të UÇK-së gjatë luftës. Madje u dënuan edhe për raste që Tribunali Ndërkombëtar i Hagës kishte shpallur pafajësi më herët”, shtoi ai.

Sipas Hamzës, beteja e popullit të Kosovës për të vërtetën dhe drejtësinë nuk përfundon sot. “Procesi juridik nuk ka përfunduar dhe fjala e fundit e

drejtësisë ende nuk është thënë. Nuk është e njëjta gjë të provohet se gjatë luftës janë kryer krime dhe të provohet se katër individë të caktuar kanë pasur një qëllim të përbashkët kriminal për kryerjen e tyre. Për secilin prej të akuzuarve duhet të provohet, jo vetëm pozita që ka mbajtur, sepse pozita në një strukturë nuk mund ta zëvendësojë provën e përgjegjësisë individuale. Gjatë këtij procesi janë dëgjuar dëshmi të rëndësishme për strukturën dhe funksionimin real të UÇK-së. Njerëz që gjatë viteve 1998 dhe 1999 kishin kontakte të drejtpërdrejta me UÇK-në, përfshirë përfaqësues të lartë amerikanë dhe të NATO-s, të cilët kanë dëshmuar për natyrën e decentralizuar të organizimit të saj dhe për kufizimet e strukturës së komandës dhe kontrollit”, tha ai.

Hamza tha se pret që në Apel të shqyrtohen me rigorozitet të plotë konkluzionet mbi qëllimin e përbashkët, përgjegjësinë individuale, autoritetin dhe kontrollin real, vlerësimin e dëshmiave dhe çdo çështje faktike apo juridike që mund të ketë ndikuar në aktgjykim. “Po aq i rëndësishëm është një konstatim tjetër. Edhe çështja e dëshmitarëve kërkon vëmendje të veçantë. Vetë Paneli ka folur për probleme serioze me dëshmitë e disa prej tyre. Prandaj duhet parë me rigorozitet sesi janë vlerësuar deklaratat e ndryshme, si janë trajtuar kundërthëniet dhe mbi cilat dëshmi janë mbështetur konkluzionet vendimtare për fajësinë. Në fund, të gjitha këto çështje kthehen te një standard i vetëm: përtej dyshimit të arsyeshëm. Në të drejtën penale nuk mjafton që një version i ngjarjeve të jetë i mundshëm, apo edhe më bindës se një tjetër. Kur një njeri dënohet me 13, 18 apo 25 vjet burg, fajësia e tij individuale duhet të jetë provuar përtej dyshimit të arsyeshëm”, shtoi Hamza.

Konjufca: Vendim i padrejtë dhe i pamerituar

Ministri i Jashtëm i Kosovës, Glauk Konjufca, e ka cilësuar aktgjykimin ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së “të trishtueshëm”.

“Është një vendim vërtet i trishtueshëm, i padrejtë, i pamerituar për katërshen udhëheqëse të UÇK-së”, tha Konjufca pas shpalljes së aktgjykimit në Hagë.

Edi Rama reagon pas aktgjykimit të Speciales: “Marre”

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka reaguar pas shpalljes së aktgjykimit ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Rama publikoi në rrjetet sociale një fotografi me vetëm një fjalë: “Marre”, duke shprehur, siç duket, kundërshtimin e tij ndaj vendimit të Dhomave të Specializuara. Reagimi i tij erdhi pak pasi trupi gjyqësor i shpalli katër ish-krerët e UÇK-së penalisht përgjegjës për krime lufte dhe u shqiptoi dënime me burgim.

Ali Ahmeti e quan “të padrejtë” aktgjykimin ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Udhëheqësi i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) në Maqedoninë e Veriut dhe një

nga bashkëthemeluesit e UÇK-së, Ali Ahmeti, e ka cilësuar “të padrejtë dhe thellësisht zhgënjyes” aktgjykimin ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit. Ahmeti bëri thirrje për maturi dhe unitet, duke kërkuar që të shmangen tensionet dhe përçarjet pas shpalljes së dënimeve. Ai theksoi se të katërtit u liruan nga akuzat për krime kundër njerëzimit dhe se pretendimet e mëhershme për trafikim organesh nuk u përfshinë në akuzat e këtij procesi. “Këto janë fakte që duhet të kujtohen sa herë që dikush përpiqet ta paraqesë UÇK-në si ndërmarrje kriminale”, tha Ahmeti.

Ai shprehu bindjen se gjetjet për të cilat katër ish-krerët e UÇK-së u shpallën fajtorë, do të kundërshtohen në procesin e apelit. “Procesi nuk përfundon këtu. Besojmë se mbrojtja do ta vazhdojë betejën juridike në Gjykatën e Apelit, duke kundërshtuar gjetjet e shkallës së parë dhe duke kërkuar drejtësi deri në fund”, shkroi Ahmeti në rrjetet sociale.

PDK-ja: Aktgjykim i padrejtë dhe i papranueshëm, beteja për drejtësi vazhdon deri në fund

Partia Demokratike e Kosovës shpreh indignatën, zhgënjimin dhe kundërshtimin e saj për aktgjykimin e sotëm të Gjykatës Speciale në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. “Sot në Hagë u godit rëndë e drejta e popullit tonë që luftoi për liri, mbijetesë dhe çlirim nga regjimi shtetëror serb që vrau, dëboi dhe terrorizoi shqiptarët e Kosovës. Për ne, ky aktgjykim është një padrejtësi e madhe, sepse mbështetet në pretendime e materiale që i konsiderojmë të fabrikua dhe të ushqyera ndër vite nga aparati shtetëror dhe propaganda e Serbisë për ta kriminalizuar luftën e drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ky aktgjykim mund të jetë shkruar në Hagë. Por historia e

Kosovës është shkruar këtu, me sakrificë, gjak dhe luftë për liri. Dhe ajo nuk rishkruhet sot. Historia jonë është shkruar nga populli ynë që luftoi për mbijetesë, nga mijëra dëshmorë e martirë, nga qindra mijëra qytetarë të dëbuar prej shtëpive të tyre dhe nga një aleancë historike me botën demokratike që, në vitin 1999, i dha fund represionit dhe spastrimit etnik të regjimit serb në Kosovë. Agresori ishte Serbia. Viktima ishte Kosova. Dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte përgjigjja e popullit tonë që kërkonte të jetonte i lirë. Këtë të vërtetë nuk mund ta ndryshojë asnjë aktgjykim”, thuhet në reagimin e PDK-së.

PDK-ja thekson se Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi nuk shkuan në Hagë duke ikur nga drejtësia. “Ata iu përgjigjën asaj vullnetarisht, me besimin se e vërteta do të triumfojë. Prandaj, vendimi i sotëm është një goditje e rëndë për luftën e UÇK-së, lirinë, pavarësinë dhe shtetin e Kosovës. Sot, qytetarët e Kosovës ndihen të lënduar dhe të zhgënjyer nga ky aktgjykim i padrejtë. PDK do ta kundërshtojë këtë aktgjykim me argumente, me të gjitha mjetet demokratike dhe në çdo forum ku duhet mbrojtur e vërteta për luftën e Kosovës. Për ne, lufta e UÇK-së ishte e drejtë, mbrojtëse dhe çlirimtare. Dhe njerëzit që udhëhoqën luftën dhe proceset politike që sollën lirinë dhe shtetin e Kosovës nuk mund të fshihen nga historia me një vendim gjyqësor. Sot është një ditë e rëndë për Kosovën. Por sot nuk përfundon as historia, as beteja për të vërtetën”, thuhet në reagim.

Partia Demokratike e Kosovës ka njoftuar se do të qëndrojë përherë në mbrojtje të së vërtetës historike, të dinjitetit të luftës çlirimtare dhe të atyre që morën mbi vete barrën e lirisë së Kosovës. “Ky aktgjykim nuk është fjala e fundit. Ne për drejtësinë do të luftojmë deri në fund dhe për të vërtetën nuk do të heshtim kurrë. Heronjtë tanë të luftës dhe paqes nuk do t'i lëmë kurrë vetëm. Beteja vazhdon, me ta dhe për ta, deri në lirinë e tyre”, thuhet në reagimin e PDK-së.



Haradinaj bën thirrje për qetësi: Beteja për drejtësi të vazhdojë në shkallën e dytë

Ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, tani deputet i Aleancës, e ka cilësuar “të papranueshëm” dhe “të padrejtë” aktgjykimin dënues ndaj ish-krerëve të UÇK-së, ndërsa ka bërë thirrje për qetësi dhe për vazhdimin e betejës ligjore në shkallën e dytë. “Beteja për drejtësi duhet të vazhdojë, duhet të fitohet në shkallën e dytë”, tha Haradinaj përmes një video-mesazhi të shpërndarë në rrjetet social. Ai u bëri thirrje qytetarëve që të mos dëmtojnë pronën dhe të mos rrezikojnë jetën e njerëzve si reagim ndaj aktgjykimit. “Nëse e shkatërrojmë Kosovën, u ndihmojmë armiqve. Do t’i mundim armiqtë të bashkuar”, tha Haradinaj. Edhe kryetari i Aleancës, Ardian Gjini, ka reaguar pas aktgjykimit të Gjykatës Speciale ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjini ka thënë se dënimet ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit janë “tronditëse dhe thellësisht zhgënjyese”. “Sot mendjet dhe zemrat tona janë me familjet e tyre, me bashkëluftëtarët dhe me gjithë popullin e Kosovës. Ky aktgjykim nuk mund ta ndryshojë të vërtetën historike. Ushtria Çlirimtare e Kosovës zhvilloi luftë të drejtë dhe çlirimtare kundër regjimit kriminal të Serbisë. Sot, Kosova është e lirë dhe sovrae falë luftës së djemve dhe vajzave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe falë mbështetjes së pa rezervë të aleatëve tanë! Ta ruajmë Kosovën sepse në atë mënyrë nuk ju japim armiqve kënaqësinë që e presin. Kosova duhet të bëjë shumë më shumë që katër udhëheqësit e UÇK-së të shpallen të lirë në shkallën e dytë të gjykimit”, ka shkruar Gjini në “Facebook”.

LDK-ja: Djemtë e vajzat e UÇK-së mbrojtën prapun e shtëpisë

Lidhja Demokratike e Kosovës ka theksuar në një komunikatë për

medie se ka pritur me shqetësim shumë të thellë aktgjykimin ndaj ish-udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe përmasën e dënimeve ndaj tyre. “Të vetëdijshëm për ndjeshmërinë e këtij momenti për qytetarët e vendit, bëjmë thirrje për qetësi, maturi dhe përgjegjësi. Liria dhe pavarësia e Kosovës mbështeten në sakrificën e brezave, në rezistencën politike e paqësore të udhëhequr nga Presidenti Ibrahim Rugova, në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe në mbështetjen vendimtare të aleatëve tanë, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e të Aleancës Veriatlantike NATO. Kjo trashëgimi është e përbashkët dhe përgjegjësia për ta ruajtur atë na takon të gjithëve. Asnjë aktgjykim, as ky i sotmi, nuk mund ta zhbëjë të vërtetën historike të luftës në Kosovë. Regjimi i Serbisë ushtroi gjenocid e krime kundër njerëzimit; zhvilloi një fushatë të egër terrori dhe spastrimi etnik në Kosovë; masakroi civilë të pafajshëm, vrau fëmijë, gra e të moshuar, ushtroi dhunë, dëboi me forcë popullsinë dhe dogji e shkatërroi fshatra e qytete të tëra. Këto krime ishin sistematike, pasojat e të cilave rëndojnë edhe sot mbi mijëra familje. Përballë kësaj egërsie, populli i Kosovës luftoi për mbijetesë dhe liri. Djemtë e vajzat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mbrojtën prapun e shtëpisë”, theksohet në komunikatë. LDK-ja mbetet e përkushtuar ndaj shtetit të së drejtës. “Mbështesim pa rezervë kërkesën për shterimin e të gjitha kanaleve ankimore, përfshirë edhe ato të shkallës së dytë. U bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve për qetësi dhe maturi. U kërkojmë përfaqësuesve politikë të tregojnë përgjegjësi në fjalët dhe veprimet e tyre, të shmangin nxitjen e tensioneve dhe të kontribuojnë në ruajtjen e qetësisë dhe të unitetit qytetar. U bëjmë thirrje të gjitha forcave politike t’i lëmë mënjatë ndasitë dhe të qëndrojmë bashkë për ta përballuar këtë periudhë të vështirë për Kosovën. Liria jonë ka kushtuar shumë. Shteti ynë është përgjegjësi e të



gjithëve. Ta ruajmë Kosovën, unitetin qytetar dhe miqësitë që i qëndruan pranë në rrugën drejt lirisë e pavarësisë. UÇK mbetet pjesa më krenare e historisë moderne të popullit tonë; dje, sot e përjetësisht”, është theksuar në komunikatën e LDK-së.

Kryetarët e komunave reagojnë pas dënimit të katërshes së UÇK-së në Hagë: Përjetë UÇK!

Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka reaguar pas shpalljes së verdiktit ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë. Rama e ka cilësuar verdiktin “të padrejtë dhe të rëndë”, duke thënë se beteja për të vërtetën dhe drejtësinë nuk përfundon me këtë vendim. “Një verdikt i padrejtë dhe i rëndë për të gjithë ne! Por ky nuk është fundi. Beteja vazhdon për të vërtetën, për drejtësinë, për dinjitetin dhe për mbrojtjen e luftës çlirimtare të UÇK-së”, ka shkruar Rama. Ai ka bërë thirrje për unitet në këto momente, duke theksuar rëndësinë e respektit për sakrificën dhe historinë e Kosovës. “Në këto momente të vështira, qëndrojmë pranë familjeve të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit”, ka deklaruar ai. Rama ka theksuar se procesi, sipas tij, duhet të vazhdojë përmes rrugëve institucionale dhe ligjore. “Një verdikt mund të shënojë një moment të vështirë, por nuk e përfundon betejën për drejtësi. Ajo vazhdon

institucionalisht, ligjërisht dhe me dinjitet”, ka shkruar kryetari i Prishtinës. Kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, e ka cilësuar vendimin si “padrejtësi”, ndërsa ka shkruar se është “shumë i tronditur” nga aktgjykimi. “Drejtësia sot u bë padrejtësi! Heronjtë tanë të luftës dhe paqes kanë qenë, janë dhe përgjithmonë mbesin të pafajshëm. Vendimin e Hagës, me qytetarë e përcollëm nga Sheshi në Drenas. Jam shumë i tronditur nga vendimi. Pafajësia është vendimi i vetëm i drejtë! Krimi kundër njerëzimit dhe Krimet e luftës, ranë poshtë. Çlirimi dhe liria ishin qëllimi i vetëm i çlirimtarëve! Qëllimi i heronjve tanë të luftës dhe paqes ishte liria dhe çlirimi i Kosovës, si e drejtë themelore për lirinë e qytetarëve të Kosovës. Rruga për çlirim nuk ishte e lehtë dhe pa ndihmën e aleatëve, NATO-s, ne nuk do ta arrinim këtë qëllim, lirinë dhe çlirimin nga okupimi gati shekullor serb”, ka shkruar Lladrovci.

Ai ka theksuar se shpifjet dhe tendencat e disa shteteve jomiqësore ndaj lirisë dhe punën për ta kriminalizuar UÇK-në ranë poshtë. “Shënjestrimi i heronjve tanë nga shteti gjenocidal, për baltosjen e qëllimeve dhe veprimeve të çlirimtarëve, është i njohur. Janë akuza shekullore të zbatuara me gjenerata, pre e të cilave ranë edhe ky trup gjykues. Adresa e vetme e krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës në Kosovë, është Serbia. Kundërshtimi i fuqishëm i këtyre vendimeve të padrejta mbetet prioritet i mbrojtjes së heronjve tanë të luftës dhe paqes, por edhe institucioneve të Kosovës”, ka shkruar Lladrovci në “Facebook”. Edhe kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi, ka reaguar kundër aktgjykimit. “Asnjëherë në emër të popullit të Kosovës! Asnjëherë në emër të popullit për të cilin luftuat! Liria që gëzojmë sot e ka zhurmën e hapave të ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ajo liri e ka një çmim: gjakun e dëshmorëve dhe sakrificën mbinjerëzore të një populli të tërë”, ka shkruar në “Facebook” Latifi.

Ai ka thënë se katërshja e madhe e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, u përballën me gjyqin më të padrejtë në histori të botës, jo për veten e tyre, por për pastërtinë e historisë sonë. “Tendenca për të njollosur luftën tonë çlirimtare është tendencë për të tjetërsuar të vërtetën e

Kosovës. Historia nuk zhbëhet dhe as nuk ndryshohet dot nëpër salla gjyqesh! Përjetë UÇK! Përjetë krenar me luftën e UÇK-së për liri! Kurrë në emrin tim! Me ju sot, nesër dhe përgjithmonë!”, ka shkruar Latifi. Ndërkaq, kryetari i Malishevës, Ekrem Kastrati, ka shkruar se “sot drejtësia na zhgënjeu”. “Sot drejtësia na zhgënjeu! Çlirimtarët tanë vazhdojnë të mbahen larg familjeve, larg atdheut! Për popullin përherë do të jeni meritoret e lirisë”, ka shkruar Kastrati.

Me reagim ka dalë edhe kryetari i Fushë-Kosovës, Valon Prebreza, i cili ka shkruar vetëm: “Jo në emrin tim!”.

Ka reaguar edhe kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi. “Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte e drejtë, e pastër dhe çlirimtare. Vendimi i sotëm është i padrejtë dhe nuk mund ta ndryshojë të vërtetën; UÇK është e gdhendur në themelet e shtetit tonë dhe zemrat e qytetarëve tanë”, ka shkruar Bulliqi.

Edhe kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka reaguar pas aktgjykimit. Ai ka publikuar vetëm një fotografi në rrjetet sociale “No coment”.

BE-ja bën thirrje për përmbytje pas aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

Bashkimi Evropian u ka bërë thirrje të gjitha palëve dhe aktorëve në Kosovë dhe në rajon që të tregojnë përmbytje pas aktgjykimit ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Në një deklaratë për Radion Evropa e Lirë, zëdhënësi i BE-së, Guillaume Mercier, tha se Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar duhet të lejohen ta ushtrojnë mandatin e tyre pa ndërhyrje. “Drejtësia duhet të lejohet të ndjekë rrjedhën e saj - gjë që është veçanërisht e rëndësishme për viktimat. Autoritetet kanë përgjegjësinë të garantojnë sigurinë e të gjitha komuniteteve dhe banorëve në mbarë Kosovën”, tha Mercier.

BE-ja tha se “merr shënim” aktgjykimin e shkallës së parë dhe vlerësoi se Dhomat e Specializuara po administrojnë drejtësi përmes procedurave “të drejta, të paanshme dhe të pavarura”, të bazuara në parimin e përgjegjësisë penale



individuale. Mercier rikujtoi se personat e dënuar kanë të drejtë ta apelojnë aktgjykimin para një paneli të veçantë të gjyqtarëve të Apelit. BE-ja ritheksoi, gjithashtu, mbështetjen e saj për Dhomat e Specializuara, duke kujtuar se ato u krijuan me vendime të Kuvendit të Kosovës më 2014 dhe 2015 dhe funksionojnë brenda sistemit juridik të Kosovës. Sipas BE-së, puna e tyre është e rëndësishme për përgjegjësinë penale dhe drejtësinë për viktimat dhe familjet e tyre nga të gjitha komunitetet në Kosovë, si dhe për pajtimin. “Është thelbësore të promovohet një mjedis pa frikë dhe hakmarrje dhe të mbrohen viktimat dhe dëshmitarët”, tha Mercier për REL-in.

Qindra qytetarë mbledhen pranë EULEX-it pas aktgjykimit në Hagë

Qindra qytetarë janë mbledhur pranë ndërtesës së Misionit të BE-së për Sundim të Ligjit, EULEX, në zonën industriale në Prishtinë, pas shpalljes së aktgjykimit ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Disa prej tyre kanë hedhur gurë në drejtim të ndërtesës. Tubimi u organizua pasi Dhomat e Specializuara në Hagë i dënuan katër ish-krerët e UÇK-së për krime lufte, me dënime që shkojnë nga 13 deri në 25 vjet burgim. Nuk është bërë menjëherë e qartë pse protestuesit kanë zgjedhur ndërtesën e EULEX-it si vend të tubimit. Megjithatë, ky mision ka rol mbështetës ndaj Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, të cilave u ofron mbështetje logjistike dhe operacionale, ndërsa BE-ja është financuesja kryesore e tyre. Udhëheqësit politikë në Kosovë kanë bërë thirrje për qetësi dhe përmbajtje.

Tensione edhe pranë Gjykatës Speciale në Hagë

Disa medie raportuan për tensione pranë ndërtesës së Dhomave të Specializuara në Hagë pas shpalljes së aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së. Sipas raportimeve dhe pamjeve të



publikuara në rrjetet sociale, disa persona u ngjitën mbi automjetet e policisë dhe i goditën ato, ndërsa policia përdori ujë për shpërndarjen e turmës. Situata raportohet se më pas është qetësuar.

Mediet më të mëdha franceze: Thaçi, nga ‘George Washingtoni i Kosovës’, tek i dënuari në Hagë

Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i dënuar të mërkurën me 25 vjet burgim për krime lufte, prej kohësh është parë brenda vendit ballkanik si një hero gueril dhe simbol i luftës së përgjakshme për pavarësi. Thaçi, i cili u shpall fajtor nga një gjykatë e posaçme në Hagë për krime lufte të kryera nga luftëtarë guerilë, përfshirë vrasje, arrestim dhe ndalim arbitrar, trajtim mizor dhe torturë, udhëhoqi Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), e cila ishte pro-pavarësisë, gjatë luftës së viteve 1998-1999 me Serbinë, shkruan mediumi francez “France24”, duke cituar agjencinë ndërkombëtare të lajmeve me seli në Paris, Agence France-Presse (AFP). 58-vjeçari - i cili gjithashtu shërbeu për më shumë se shtatë vjet kryeministër - e pa popullaritetin e tij të rritej ndjeshëm kur ndihmoi në

mbikëqyrjen e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Por imazhi i tij u dëmtua nga një raport i Këshillit të Evropës i vitit 2010, ku pretendohet se kishte lidhje me krimin e organizuar dhe abuzime të rënda të kryera gjatë dhe menjëherë pas luftës. Kritikët e akuzuan, gjithashtu, ish-udhëheqësin dhe partinë e tij për korrupsion dhe përqendrim të pushtetit te aleatët politikë. Por ishin akuzat e lidhura me kohën e luftës ato që i dhanë fund papritur presidencës së tij dhe e lanë atë në paraburgim në Hagë. Ai u akuzua në vitin 2020 për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, nën akuzën se mbante përgjegjësi për vrasje, torturë, ndalim të paligjshëm dhe zhdukje me forcë gjatë dhe pas konfliktit. “Këto nuk janë momente të lehta për mua dhe familjen time, si dhe për ata që më kanë mbështetur dhe besuar në tri dekadat e fundit të luftës sonë për liri, pavarësi dhe ndërtimin e shtetit”, tha ai në vitin 2020, kur njoftoi dorëheqjen dhe dorëzimin e tij në gjykatë. Shumë njerëz e ndoqën të mërkurën drejtpërdrejt shpalljen e aktgjykimit në një ekran të vendosur në një shesh në kryeqytet, Prishtinë, ku një orë numërimi mbrapsht kishte numëruar ditët deri në shpalljen e vendimit. Të shtunën dhjetëra mijëra njerëz u mbledhën në Prishtinë për ta

kërkuar pafajësinë e Thaçit dhe të ish-udhëheqësve të tjerë guerilë.

“Gjarpri”

I lindur në vitin 1968 në rajonin e Drenicës, në pjesën perëndimore të Kosovës - një vatër e rezistencës së shqiptarëve etnikë ndaj sundimit serb - Thaçi u përfshi në përpjekjet e rezistencës paqësore kundër sundimit të Beogradit si student në vitet 1990. Gjatë studimeve të historisë në Zvicër, ku jeton një diasporë e madhe shqiptare, ai u zhgënjye nga politika e rezistencës paqësore të promovuar nga ish-presidenti i Kosovës, Ibrahim Rugova. Pas kthimit në Kosovë, ai mori nofkën e luftës “Gjarpri”, teksa ndihmoi në ndërtimin e një ushtrie guerile nëntokësore, UÇK-së, për të luftuar për pavarësinë nga forcat e të fortit serb Slobodan Millosheviq. Konflikti la pas vetes rreth 13 000 të vrarë, kryesisht shqiptarë etnikë, dhe përfundoi pasi NATO-ja ndërhyri në vitin 1999, duke i dëbuar forcat serbe. Gjykatat ndërkombëtare më vonë dënuan disa zyrtarë të lartë të ushtrisë dhe policisë serbe për krime të kryera gjatë konfliktit. Ndërsa Kosova vazhdonte të kërkonte shtetësinë, Thaçi u bë një nga figurat e saj më të rëndësishme politike. Gjatë një vizite në Shtëpinë e Bardhë, Joe Biden, atëherë

nënpresident i ShBA-së, e cilësoi atë si “George Washingtonin e Kosovës”. Pas vdekjes së Rugovës, i cili konsiderohej gjerësisht si babai i kombit, Thaçi u bë kryeministër pas zgjedhjeve të vitit 2007. Tre muaj më vonë, ai lexoi në Kuvend deklaratën e pavarësisë, duke shpallur shkëputjen e njëanshme të Kosovës nga Serbia - një veprim që Beogradi ende nuk e njeh. Pavarësisht akuzave për korrupsion, ai mbeti në qendër të politikës dhe u zgjodh president në vitin 2016. Ai gjithmonë ka mohuar çdo keqbërje gjatë luftës, duke e përshkruar atë si një rebelim “të drejtë” kundër represionit serb. “Mund të kem bërë gabime politike në kohë paqeje, por krime lufte, kurrë”, tha ai në vitin 2020.

Grenelli kërkon zhbërjen e Gjykatës Speciale

Emisari presidencial i Trumpit, Richard Grenell, ka reaguar pas vendimit të Gjykatës Speciale. Grenelli ka thënë se kryeministri Albin Kurti duhet të veprojë shpejt për ta zhbërë Gjykatën Speciale dhe, sipas tij, deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet ta ndihmojnë. “Dënimi i shpallur nga Gjykata e Hagës ndaj Hashim Thaçit, për një luftë të zhvilluar 25 vjet më parë, është i turpshëm. Askush nuk është i sigurt nga këto gjykata ndërkombëtare, ku elitat akademike marrin vendime politike. Këta tre gjyqtarë dhe prokurori amerikan janë të gjithë të majtë ekstremë. Ata qartazi nuk i dëgjuan këshilltarët e Bill Clintonit, të cilët e bënë të qartë se Thaçi nuk e drejtonte luftën. Gjyqtari zviceran Guénaël Mettraux ishte në të vërtetë udhëheqësi, duke injoruar çështjet ligjore dhe duke zgjedhur në vend të tyre politikën e Jack Smithit. Departamenti i Drejtësisë i ShBA-së dhe prokurori i përgjithshëm Todd Blanche duhet të veprojnë shpejt. Amerikanët po paguajnë për këto ndjekje penale politike dhe kjo duhet të ndalet. Edhe Albin Kurti duhet të veprojë shpejt për ta shpërbërë këtë gjykatë të huaj. Anëtarët e Kuvendit duhet të punojnë me Kurtin për ta bërë këtë të mundur. Kosovës nuk i duhet një gjykatë në Holandë”, ka shkruar Grenelli.



Gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar vizitojnë Agjencinë për Informim dhe Privatësi

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Në kuadër të Programit Fillestar për gjyqtarë dhe prokurorë të rinj, Agjencia për Informim dhe Privatësi priti për vizitë pjesëtarët e Gjeneratës XIV dhe XV, në bashkëpunim me Akademikën e Drejtësisë.

Komisionerja Krenare Sogojeva Dërmaku paraqiti funksionet dhe përgjegjësitë kryesore të Agjencisë, me theks të veçantë në mbrojtjen e të dhënave

personale dhe garantimin e qasjes në dokumente publike, në kontekstin e procedurave gjyqësore.

Përmes shembujve konkretë nga praktika, pjesëmarrësit u njohën me parimet themelore të mbrojtjes së të dhënave personale, me fokus në rëndësinë e trajtimit të kujdesshëm të provave dhe të të dhënave personale gjatë fazave

të hetimit dhe shqyrtimit gjyqësor.

Në përmbyllje të takimit, komisionerja Sogojeva Dërmaku rikonfirmoi gatishmërinë e Agjencisë për të ofruar mbështetje profesionale dhe këshilla në zbatimin e drejtë të legjislacionit përmes një bashkëpunimi të qëndrueshëm dhe të frytshëm me sistemin e drejtësisë.



MICS 2025: PËRPARIM PËR FËMIJËT NË KOSOVË, POR PABARAZITË MBETEN TË THEKSUARA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU


PRISHTINË, 16 SHTATOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës dhe UNICEF-i në Kosovë publikuan gjetjet e Anketës së Treguesve të Shumëfishtë (MICS) 2025, anketës më gjithëpërfshirëse të ekonomive familjare mbi gjendjen e fëmijëve, grave dhe familjeve në Kosovë.

Gjetjet tregojnë përparim të dukshëm për fëmijët, njëkohësisht zbulojnë pabarazi të vazhdueshme dhe, në disa fusha, të theksuara që prekin fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë.

Drejtori i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Avni Kastrati, theksoi se në agjencinë që drejton janë të përkushtuar për të prodhuar të dhëna cilësore dhe ndërkombëtarisht të krahasueshme që i shërbejnë interesit publik. "Gjetjet e MICS 2025 ofrojnë dëshmi thelbësore për monitorimin e progresit, identifikimin e pabarazive dhe mbështetjen e politikave që përmirësojnë jetën e fëmijëve dhe familjeve në mbarë Kosovën", ka thënë ai.

Stephen O'Malley, koordinator i Zhvillimit të OKB-së në Kosovë, ka theksuar se në mbarë botën MICS është një nga mjetet më të rëndësishme që mbështet OKB-jën. "Kudo që kam punuar ai ka shërbyer si një pikë kyçe referimi për qeverinë, partnerët dhe planifikimin e programeve të OKB-së. Ai gjeneron të dhëna që nuk gjenden askund tjetër dhe na ndihmon ta përqendrojmë vëmendjen te njerëzit më të cenueshëm në shoqëritë tona", ka deklaruar O'Malley.

Si raundi i tretë i MICS-it në Kosovë, pas anketave të viteve 2014 dhe 2020, kjo anketë mundëson vlerësimin e përparimit ndër vite: mbijetesa e fëmijëve është përmirësuar, pjesëmarrja në edukimin në



fëmijërinë e hershme është më shumë se dyfishuar, gatishmëria për shkollë ka vazhduar të rritet dhe përdorimi i disiplinës jo të dhunshme është shtuar. Megjithatë, pabarazitë mbeten të mëdha, me fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë që përballen me rreziqe dukshëm më të larta në mbijetesë, ushqyerje, arsim dhe mbrojtje. "Gjetjet e reja të MICS-it tregojnë se përparimi për fëmijët në Kosovë është real, por ende jo i barabartë. Tashmë kemi tri raunde të dëshmi të krahasueshme që tregojnë se ku investimet po japin rezultate dhe ku fëmijët ende po mbeten prapa. Detyra e përbashkët është e qartë: t'i përdorim këto të dhëna për të orientuar burimet dhe shërbimet në mënyrë që çdo fëmijë të mund të mbijetojë, të mësojë, të mbrohet dhe të zhvillohet", tha Veronika Vashchenko, shefe e Zyrës së UNICEF-it në Kosovë. Gjetjet kryesore tregojnë se vdekshmëria neonatale ka rënë

nga 11 në 8 vdekje për 1 000 lindje të gjalla në Kosovë, rënie 27 % nga viti 2020, ndërsa te komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian ka rënë nga 21 në 15, një rënie prej 29 % nga viti 2020. Imunizimi i plotë të fëmijët e moshës 24-35 muaj qëndron në 76 % te popullata e përgjithshme dhe 44 % te fëmijët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian.

Pjesëmarrja në edukimin në fëmijërinë e hershme për fëmijët e moshës 3-4 vjeç është më shumë se e dyfishuar, nga 15 % në vitin 2020, në 36 % në vitin 2025, por mbetet rreth 7 % te fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë. Hendeku në arsim dhe mbrojtje mbeten gjithashtu të theksuara.

Vijueshmëria në shkollë në popullatën e përgjithshme është 96 % në arsimin fillor, 95 % në arsimin e mesëm të ulët dhe 89 % në arsimin e mesëm të lartë, ndërsa te fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë ajo bie nga 83 % në arsimin fillor, në 27

% në arsimin e mesëm të lartë. Disiplina e dhunshme ka rënë nga 72 në 64 %, ndërsa dhuna e rëndë nga 6 në 2 %, por dhuna ndaj fëmijëve mbetet ende e përhapur.

Ushqyerja paraqet një sfidë tjetër në Kosovë. 24 % e fëmijëve të moshës 5-9 vjeç dhe 32 % e fëmijëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë konsiderohet se janë mbi peshë. 57 % e fëmijëve të moshës 6-23 muaj dhe 80 % e fëmijëve të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian konsumojnë ushqim jo të shëndetshëm.

Transferet sociale arrijnë 94 % të fëmijëve nën moshën 18-vjeçare dhe 80 % të popullsisë që jetojnë në familje dhe që pranojnë çfarëdo lloji të transfereve sociale, duke ofruar një bazë të rëndësishme për një mbrojtje sociale më të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve.

MICS 2025 bazohet në afro 14 000 intervista të realizuara në 6

928 ekonomi familjare përmes dy anketave të ndara.

Të dhënat mund të ndahen sipas vendbanimit, seksit, moshës, arsimit, pasurisë, përkatësisë etnike dhe statusit të aftësisë së kufizuar, duke ndihmuar institucionet të shohin përtej mesatareve dhe t'i identifikojnë vendet ku pabarazitë vazhdojnë. Treguesit e saj mund ta mbështesin vendimmarrjen politike dhe buxhetore, ta forcojnë llogaridhënien dhe ta monitorojnë përparimin ndaj zotimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Gjetjet u ofrojnë institucioneve të Kosovës, partnerëve zhvillimorë, shoqërisë civile, akademisë dhe komuniteteve, një bazë të përbashkët dëshmi për t'i ruajtur arritjet dhe për ta përshpejtuar përparimin për fëmijët, veçanërisht për ata që mbeten më së shumti prapa.

Jeton Zulfaj emërohet kryenegociator i Republikës së Kosovës me BE-në

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka

emëruar Jeton Zulfaj në pozitën e kryenegociatorit të Republikës së Kosovës me Bashkimin

Evropian. Kryenegociatori është përgjegjës për të gjitha çështjet të cilat ndërlidhen me procesin

e integritetit të Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian.



RAPORTI I PAVARUR I GRUPIT TË BANKËS BOTËRORE VLERËSON LART PËRPARIMIN E SEKTORIT FINANCIAR DHE AVANCIMIN E REFORMAVE TË UDHËHEQURA NGA BQK-JA

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) mirëpret vlerësimin pozitiv të publikuar nga Independent Evaluation Group (IEG) të Grupit të Bankës Botërore, për mbështetjen e dhënë ndaj sektorit financiar të Kosovës dhe progresin e arritur gjatë viteve të fundit. IEG është strukturë e pavarur e vlerësimit të Grupit të Bankës Botërore (BB), që raporton drejtpërdrejt te Bordi Ekzekutiv dhe ka mandat ta vlerësojë efektivitetin dhe rezultatet e programeve të Grupit të Bankës Botërore në vendet anëtare. Misioni vlerësues dhe faktmbledhës i Bankës Botërore u mirëprit nga BQK në takimin e mbajtur më 8 dhjetor 2025. Raporti thekson arritje të rëndësishme në forcimin e institucioneve financiare, modernizimin e infrastrukturës financiare dhe avancimin e reformave që mbështesin integrimin e Kosovës në tregjet financiare evropiane.

Sipas këtij vlerësimi të pavarur, BQK ka luajtur rol kyç në forcimin e stabilitetit financiar, avancimin e kornizës rregullative dhe mbikëqyrëse si dhe në modernizimin e sistemit të pagesave. Në raport vlerësohet se korniza mbikëqyrëse e BQK-së është harmonizuar në masë të madhe me standardet dhe praktikën e Bashkimit Evropian, ndërsa reformat e ndërmarra kanë kontribuar në rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit financiar. Po ashtu, raporti nënvizon punën e BQK-së në avancimin e mbikëqyrjes së bazuar në rrezik dhe në forcimin e mekanizmave për menaxhimin e krizave dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Një pjesë e rëndësishme e raportit i kushtohet reformimit të sistemit të pagesave dhe përgatitjeve për integrimin në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA). Raporti konstaton se BQK ka udhëhequr procesin e modernizimit të infrastrukturës

kombëtare të pagesave dhe harmonizimit të saj me standardet evropiane, duke krijuar bazë të rëndësishme për pagesa më efikase, më të shpejta dhe më të sigurta për qytetarët dhe bizneset. Raporti thekson gjithashtu se Strategjia Kombëtare e Pagesave dhe reformat në këtë fushë kanë ndikuar në zgjerimin e përdorimit të pagesave elektronike dhe në avancimin e transformimit digjital të sektorit financiar. Këto zhvillime, sipas raportit, krijojnë kushte më të mira për rritjen e konkurrencës, nxitjen e inovacionit, zgjerimin e përfshirjes financiare dhe forcimin e mbrojtjes së konsumatorëve. Megjithatë raporti konfirmon përpunimin e dukshëm të arritur përmes reformave në sektorin financiar, ai thekson se disa nga përfitimet më të rëndësishme pritet të materializohen plotësisht në fazën e zbatimit gjatë viteve në vijim. BQK e vlerëson lart



bashkëpunimin me Bankën Botërore dhe e konsideron këtë vlerësim si konfirmim të rëndësishëm të përpunimit të arritur në forcimin e sektorit financiar të vendit. BQK mbetet e përkushtuar në vazhdimin e reformave që forcojnë stabilitetin financiar, mbështesin zhvillimin e tregjeve financiare dhe avancojnë integrimin evropian të sektorit financiar të Kosovës, në

përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare dhe objektivat strategjike të vendit. Raporti për Kosovën është pjesë e një vlerësimi më të gjerë dhe afatgjatë të angazhimit të Grupit të Bankës Botërore. Në këtë kuadër është analizuar edhe zhvillimi i sektorit financiar dhe mbështetja për forcimin e rolit të BQK-së dhe zbatimin e reformave të ndërmarra.

LIDHJA E BIZNESEVE TË KOSOVËS NË FORUMIN PUBLIK TË OBT-s: KOSOVA DREJT INTEGRIMIT NË EKONOMINË GLOBALE

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Kosova po merr pjesë në Forumin Publik të Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT), një nga ngjarjet më të rëndësishme ndërkombëtare që mbledh përfaqësues të institucioneve, organizatave ekonomike, dhomave të tregtisë dhe komunitetit të biznesit nga vende të ndryshme të botës. Në njoftim thuhet se në këtë forum po e përfaqëson delegacioni i Lidhjes së Bizneseve të Kosovës, i kryesuar nga kryetari Besart Dreshaj, së bashku me nënkryetarin Hashim Dëshishku. Gjatë pjesëmarrjes në Forum, delegacioni i Lidhjes së Bizneseve të Kosovës po zhvillon takime të rëndësishme me personalitete dhe përfaqësues të nivelit të lartë të institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare. Në kuadër të këtyre takimeve, Besart Dreshaj pati takime dhe bashkëbisedime me drejtoreshën e përgjithshme të OBT-së, Ngozi Okonjo-Iweala, John Denton, sekretar i përgjithshëm i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC), si dhe me përfaqësues të Dhomës së Tregtisë së Gjenevës



dhe drejtues e përfaqësues të tjerë të rëndësishëm të komunitetit ekonomik ndërkombëtar. “Në këto takime u diskutua për zhvillimin ekonomik të Kosovës, forcimin e sektorit privat, rritjen e bashkëpunimit tregtar dhe investimeve si dhe perspektivën

e Kosovës për integrim më të fuqishëm në sistemin ekonomik dhe tregtar ndërkombëtar. Kryetari Dreshaj paraqiti potencialet dhe të arriturat e Kosovës në fushën e ekonomisë dhe tregtisë, duke theksuar rëndësinë e mbështetjes ndërkombëtare dhe të

bashkëpunimit me partnerët strategjikë. Një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe rritjes së përkrahjes për Kosovën në rrugën drejt anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë”, thuhet në njoftim. Po ashtu, më tutje thuhet se delegacioni i Lidhjes së Bizneseve

të Kosovës zhvilloi takime me kryetarë dhe përfaqësues të Dhomave të Tregtisë nga shtete të ndryshme, ku u diskutuan mundësitë për bashkëpunim ekonomik, investime, rritjen e shkëmbimeve tregtare, partneritete ndërmjet bizneseve dhe organizimin e forumeve B2B. “Këto takime janë një dëshmi e rëndësishme që ka diplomacia ekonomike në promovimin e Kosovës dhe në krijimin e mundësive të reja për bizneset e Kosovës në tregjet ndërkombëtare. Pjesëmarrja e Kosovës në Forumin Publik të OBT-së përbën një mundësi të rëndësishme për ta ngritur zërin e Kosovës në arenën ndërkombëtare, për ta promovuar potencialin e saj ekonomik dhe për t'i forcuar marrëdhëniet me institucionet dhe komunitetin ndërkombëtar të biznesit. Lidhja e Bizneseve të Kosovës do të vazhdojë të angazhohet fuqishëm në funksion të interesave të komunitetit të biznesit, promovimit të Kosovës dhe krijimit të urave të reja të bashkëpunimit ekonomik ndërkombëtar”, thuhet në njoftim.

Konsumi i energjisë në Kosovë u rrit 21.2 për qind në korrik krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e energjisë për muajin korrik 2026 me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të

tjerë.

Në muajin korrik 2026 prodhimi bruto i energjisë elektrike nga hidrocentralet ishte 14.12 GWh, ku krahasuar me korrik 2025, u rrit për 91,71 %. Energjia elektrike bruto në dispozicion ishte 451.37 GWh ose (-11,26 %) më pak krahasuar me muajin e njëjtë të

vitit paraprak, kurse konsumi i energjisë elektrike ishte 415.84 GWh ose 21,20 % më i madh krahasuar me muajin e njëjtë të vitit paraprak. Pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 8,31 %. Importi i energjisë elektrike në korrik të vitit 2026 ishte 319.99

GWh, kurse eksporti i energjisë elektrike në të njëjtën periudhë ishte 289.45 GWh (këtu është e përfshirë edhe sasia e transmissioinit). Prodhimi i thëngjillit për muajin korrik 2026 ishte 476.649 mijë tonë, që paraqet një rritje prej 25,28 %, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar.



RRËFIMI I FLORA BROVINËS PËR FËMIJËRINË (2001): MA BURGOSËN BABANË NË DITËLINDJEN TIME TË PESTË

Flora Brovina, humaniste, poete dhe deputete në Parlamentin e Kosovës, flet për fëmijërinë e saj, për ditën kur ishte burgosur babai i saj, për kujdesin e nënës dhe të gjyshes, për varrimin në rrethana të jashtëzakonshme të stërgjyshes së saj, për axhën e burgosur, për dajallarët e arratisur në Shqipëri, për fustanin dhe kordelet në ditën e parë të shkollës, për netët pa gjumë, për ëndrrat e tronditura ...

Intervistoi: Agim ZOGAJ /
Javorja Politike Shqiptare
“Zëri” (intervistë e botuar në
vitin 2001, në rubrikën
“Private”, në dy vazhdimë)

NGA DRENICA NË PRISHTINË

Cilat janë arsyet që pranuat të jeni mysafire e kësaj rubrike?

Rubrikat e revistës suaj dhe në përgjithësi zhanri gazetaresk që mëton të paraqes para lexuesit një pjesë tjetërfare të jetës së personaliteteve publike, qoftë intelektuale, politike apo edhe kulturore, është mjaft atraktive. Dhe, mund të them haptas se shpesh kam dëshirë të lexoj për jetën e personaliteteve të caktuara. Kjo ishte arsyeja e parë dhe kryesorja, andaj konsideroj po ashtu se edhe rrëfimi im jetësor do të jetë tërheqës për lexuesit tuaj. Unë kam besim në rubrikën tuaj, andaj bindshëm dhe realisht do ta pasqyroj jetën time, atë që nuk e ka njohur deri tash opinioni i gjerë.

Zakonisht, në bashkëbisedimet e tilla, fillimisht orientohemi te fëmijëria e bashkëbiseduesit ... Kuptimi im për fëmijërinë është se ajo, për njeriun, pavarësisht nga mosha, paraqet frymëzim dhe përjetim të rëndësishëm në jetë. Madje, për mua fëmijëria është inspirim i madh jetësor, i kuptimit të filozofisë së jetës, por edhe diçka që ka lënë gjurmë të thella në jetën time, në krijimin e personalitetit tim dhe që ka luajtur rol të caktuar në formësimin e idealeve të mia. Në këtë kuptim, fëmijëria ime është shumë interesante, shumë dinamike, shumë asociative dhe me përplot zhvillime, edhe dramatike, që gjithsesi kanë lënë gjurmë të thella në jetën time, në shpirtin tim. Përmes asaj fëmijërie, unë kam mësuar se si duhet kuptuar jetën, njeriun, realitetet e hidhura dhe të mira, edhe stuhitë e jetës prej të cilave fëmijëria ime nuk ishte e privuar. Gjatë kësaj bisede po ndjej në shpirt një kthim në një histori edhe jo aq të largët, por gjithsesi të përzier më të mirat dhe të këqijat e veta, me ëndrrat e bukura, por edhe me shqetësimet dhe ndjenjat e rënda fëmijërore të cilat i kam përjetuar vetë. Një herë në bisedë për “ZËRI”, por edhe herëve tjera, kam thënë se jam një çikë drenicake, sepse kam lindur në Skënderaj, në kohën kur prindërit e mi ishin të zënë me punë. Kur familja e jonë, Brovina, u shpërngul nga Skënderaj, unë i kisha vetëm tre muaj, kështu që fëmijëria ime lidhet me Prishtinën ...

FËMIJËRIA E KËPUTUR DHE ËNDRRAT E NDALUARA

Ku dhe si jetonit?

Shtëpia ku ne jetonim si qiraxhinj ishte në qendër të qytetit, në rrugën e cila tash mban emrin e TMK-së. Disa metra më larg asaj shtëpie, e cila është rrënuar pasi unë kam dalë nga burgu, ishte një lagje që quhej Kaçamak. Në atë lagje pastaj arritëm të ndërtojmë shtëpinë, ku edhe tash jetojnë të afërmit e mi. E mbaj mend Prishtinën me ato rrugët e vjetra me kalldrëm dhe me dyqane të vjetra të zanateve të ndryshme. Mund të them se ishte ajo një arkitekturë shumë interesante, vërtet orientale dhe me shumë art e bukuri. Mbjaj mend se në qytet ka pasur shumë gurra me ujë të pijshëm dhe ne fëmijët gëzoheshim kur freskoheshim me atë ujë. Por, kujtoj fare mirë edhe pajtonet, pra qerret e moçme karakteristike, të cilat i tërhiqte kali. Edhe atëherë pajtonet paguheshin nëse dëshiroje të shkoje nga një vend në tjetrin në qytet. Por, vërtet ishte bukur, diçka si në ëndërr. Ne, fëmijët e lagjes, e veçmas unë, nuk kemi lëvizur shumë nëpër rrugë sepse duhej të kishim kujdes nga pajtonet. Sidomos unë kam qenë nga pak nga natyra më sensibil dhe kisha frikë nga rruga. Prandaj, kohën e lirë më së shumti e kaloja duke shikuar nga dritarja. Pra, deri në moshën 5-6 vjeçe nuk kam lëvizur shumë, por kryesisht isha e përqendruar në shikimet nga dritarja. E di se prindërit e mi kanë pasur një jetë të lumtur dhe përgjithësisht në familje, pra në kohën kur ende nuk shkoja në shkollë, kishim një harmoni dhe qetësi familjare. Unë jam rritur me përrallat e prindërve dhe sidomos të gjyshes.

Mirëpo, kjo idilë e fëmijërisë suaj me ëndrra dhe përralla nuk vazhdoi gjatë ... Çfarë ndodhi pastaj? Po, fatkeqësisht, fëmijëria ime këputet, sepse një ditë, pikërisht në ditëlindjen time të pestë, burgoset babai im, Xhaviti. Ndërkohë, kishin kaluar disa muaj që axha im, Qamil Brovina, bashkëluftëtar i Shaban Haxhisë, nga Shqipëria, gjendej në burgun e Goli Otokut. Në ditën e burgosjes së babait tim unë po qëndroja, si zakonisht, pranë dritares, duke pritur të kthehej në shtëpi. Por, papritmas, në shtëpinë ku ishim me qira u futën policët e armatosur. Kurrë nuk mund t'i shlyej nga kujtesa pamjet e rënda të asaj dite, ata policë me çizme dhe me rroba ngjyre të errët. Po, mund të pranoj se isha e tmerruar nga ato



pamje, nga ato skena dhe, gjithsesi, kjo është një nga përjetimet e mia më të rënda të jetës sime. Ata kërkonin revolen e babait, demolonin çdo gjë para veti, shanin, kërcënonin, kurse ne, fëmijët, qëndronim të strukur pranë gjyshes sonë, si të vetmen mburojë që e kishim në ato çaste. Gjyshja, si përherë, qëndroi stoike. Aty ishte edhe stërgjyshja jonë dhe nëna që kishte vetëm 23 vjet. Motra më e vogël ishte tremuajshe. Policët, ashtu të tërbuar, pastaj u larguan, ndërsa ne kuptuam se babai ishte arrestuar për shkaqe politike. Jeta e familjes sonë ndryshoi brenda natës. Ne edhe ashtu ishim familje e shënjuar si "armiqtë e shtetit", por tash me arrestimin edhe të babait, filloi një jetë tepër e rëndë për ne. Ngadalë, jeta e jonë po kthehej në një izolim të madh, sepse shumë të afërm iu largoheshin kontakteve me familjen tonë. Të them të drejtën, edhe pse e vogël dhe me moshë të një vogëlusheje, unë e ndjeja tërë atë atmosferë dhe edhe pse përpiguesha që të mos e shqetësoj nënën, gjyshen dhe stërgjyshen, megjithatë mund të vërehej se isha e thyer në shpirt.

STËRGJYSHEN NUK KISHTE KUSH TA VAR-ROSTE

Ju më vonë u regjistruat në klasën e parë, me përjetimet dhe ndjenjat e një fëmije që babë e axhë i ka në burgjet serbe?

Ishte kohë e rëndë, ishte kohë e keqe dhe, pos vetmisë së madhe shpirtërore, ne na kishte pllakosur edhe mjerimi social dhe ekonomik. Personi që më së shumti ka bërë që ne të mbijetojmë atë kohë dhe ato vite me plot mynxyrë, ishte gjyshja e jonë. Ndërkohë, nëna ime mësoi nga gjyshja të qepë dhe kështu filloi të siguronte kafshatën e bukës për familjen tonë. Nga rrobat, fustanet e motrave tjera,

nëna na qepte edhe neve më të voglave fustane të reja, kështu që kurrë nuk mund të diktohej në shkollë se unë nuk kam fustane të mira dhe të reja. Shpesh, edhe shoqet e klasës më pyesnin se ku e kam marrë ose kush ma ka qep fustanin tim. Ndonëse e vogël, pra në klasën e parë, unë vëreja atmosferën e rënduar në familjen time. Dhe, ajo që më së shumti më bënte përshtypje, ishte se nuk kishte më buzëqeshje të familjarëve, nuk kisha më kë të prisja as pranë dritares ... Ndërkohë, stërgjyshja jonë nisi të bëhej senile dhe nga ajo sëmundje kishte filluar që në pikë të ditës, ose edhe të natës, t'i kërkonte djemtë. Por, dy djemtë e saj, pra të stërgjyshes (nëna e nënës), për shkaqe politike ishin të arratisur në Shqipëri. Njëri nga ata quhej Qazim Vula, i cili akuzohej se kishte marrë pjesë në atentatin kundër Miladin Popoviqit. Pra, mund të imagjinoni se çfarë gjendje e rëndë ishte për gjyshen dhe stërgjyshen tonë. Të dyja i kërkonin të bijtë e ndjekur e të burgosur politikisht ... Stërgjyshja vdiq nga malli për djemtë e saj ... Një ditë, gjithsesi e rënduar nga mërzia, malli për djemtë, por edhe situata në momente pa shpresë, ajo ndërroi jetë. Dhe, për të qenë ironia më e madhe, stërgjyshen nuk kishte kush ta varroste, sepse të gjithë në shtëpinë tonë ishim femra. Në shtëpi, pra, ishim pa mashkull, kurse askush nga të afërmit nuk kishte guxim që të na dilte në ndihmë. Gjyshja e jonë ishte e detyruar që ta merrte stërgjyshen, ta dërgonte në xhaminë më të afërt të qytetit për t'ia bërë ceremonitë fetare. Kur ka shkuar në xhami, punëtorët e xhamisë kanë parë se aty tek e vdekura po qëndronte vetëm një grua e moshuar. Xhematit i ishte dukur diçka shumë e pazakontë kjo, por kur kuptojnë se e vdekura ishte nëna e Qazim Vulës dhe e Abdullah Vulës dhe pranë saj

nëna e Qamil e Xhavit Brovinës, i ishin bashkangjitur gjyshes dhe e kishin dërguar në varreza trupin e pajetë të stërgjyshes sonë.

PSE MË NDALUAN TË SHKOJA NË DITËLINDJEN E TITOS

Në disa intervista, madje edhe në media ndërkombëtare, keni deklaruar se ideal jete e keni gjyshen tuaj ...? Po, kam thënë dhe po e përsëris se ideali dhe modeli im për nga karakteri jetësor është gjyshja ime. Ajo më ka mësuar, thënë figurativisht, ecjen vertikale në jetë. Prej saj kam mësuar se në jetë duhet qëndruar ballëhapur para të gjitha sfidave, se duhet të jesh krenare - pavarësisht nga situatat, të dukesh mirë dhe të besosh në forcat tua. Kjo, thoshte ajo, për shkak të mikut dhe për shkak edhe të armikut. Gjyshja më thoshte se ne kemi miq, por edhe armiq. Por, që në fëmijërinë time të hershme kisha kuptuar se kishim pak, tepër pak miq. Mësimi i saj ishte po ashtu se njeriu nuk duhet të përkulet para sfidave, para vështirësive, pavarësisht se çfarë ishin ato. Nga kjo kohë, po ashtu, kujtoj blerjen e çantës së parë shkollë, të Abetares, pastaj mësuesen time të parë, Vehbie Gjinali etj. Por, e mbaj mend edhe fustanin me të cilin shkova në ditën dhe orën e parë të mësimit. Fustanin ma kishte qepur nëna ime, duke e riqepur nga fustani i saj. Dhe, askush në klasë nuk e dinte se ai fustan kishte qenë fustani i nënës sime. Nëna më kishte ndrequr disa kordele dhe unë dukeshja si një vajzë nga përrallat, e në fakt dihej se babanë dhe axhën i kisha në burg dhe se ishim në mjerim të madh social.

A e adhuroje edhe atëherë poezinë dhe leximin?

Është e mundshme që situata e përgjithshme familjare, pra e rritur larg nga babai, në një izolim të madh të shoqërisë dhe të rrethit, të ketë qenë një nga faktorët që kanë ndikuar në nxitjen e ndjenjës meditive tek unë. Por, po ashtu, jam shumë e bindur se edhe vjershat që na i lexonte nëna, kanë lënë ndikim të madh në perceptimet e mia. Ndaj, mund të them se nëna ime ishte ajo që fillimisht më ka ushqyer me dashurinë ndaj vargut të poezisë. Po ashtu, ndikim të madh në formësimin tim në këtë fushë kishte pasur edhe arsimtarja e ime e gjuhës, Liri Tanefi, nga Elbasani. Nga vitet e shkollimit fillor do të veçoj edhe faktin se unë isha një

recitatore shumë e talentuar. Por, kur kishte manifestime më të veçanta, atëherë pushteti, regjimi i atëhershëm serbo-jugosllav, e ndalonte paraqitjen time në skenë. Një ditë mësuesja më kishte lajmëruar se isha ndër ato recitatoret dhe nxënëset e shkëlqyera që mund të shkoja në ditëlindjen e Titos. Pas një ose dy ditëve erdhi përgjigjja negative se unë nuk bën dhe nuk mund të shkoja atje sepse isha nga një familja armike e shtetit. E shihni, pra, unë që nga fëmijëria ime isha në vallon e anatemit politik të regjimit. Por, ku ta dija atëherë se edhe unë do të vuaj në burgjet serbe, sikur babai dhe axha, sikur daja im - Qazim Vula.

MË PËLQENTE POEZIA DHE MATEMATIKA

Pra, në një kuptim, që nga ato vite filloi anatemi i juaj politik? Po, sepse jo vetëm në shkollë, por edhe në lagje e në shoqëri fëmijësh më shikonin më ndryshe dhe kjo më linte përshtypje ngase e ndjeja se jam diçka ndryshe, tjetërfare nga rrethi im, nga moshatarët e mi, nga shokët dhe shoqet e shkollës. Ato ndjenja kishin ndikim në emocionet e mia dhe lumturia ime si fëmijë ishte krejtësisht e kontrolluar dhe e kufizuar nga moshatarët e mi. Nuk ishte gjë që nuk hetohej për shoqërinë e atëhershme të kishë babanë dhe axhën në burgjet serbe. Unë jam shumë e bindur se edhe mësueses sime i vinte keq për këtë dhe aspak nuk ndjehej e qetë. Por, e tillë ishte jeta.

Unë, megjithatë, vazhdoja aktivitetin në grupin letrar. Në grupin tonë letrar ishin Agim Deva, Nexhat Halimi, Gani Dili dhe shokë të tjerë nga shkolla "Elena Gjika" që më vonë u bën poetë të njohur. Unë, madje, me angazhimin tim si poete u bëra kryetare e grupit letrar dhe e udhëhoqa atë për dy vjet me radhë. Në ato vite ne, edhe pse ishim në fillore, bashkëpunonim nëpërmes grupit letrar me grupet simotra të shkollave të mesme.

Shkolla "Elena Gjika", atëherë "Vuk Karaxhiq", ishte shkollë me renome. Nga lëndët që kisha më së shumti prirje dhe talent atëherë, ishte matematika. Për këtë duhet të përmendi kontributin dhe angazhimin e madh të arsimtares së matematikës, Fahrie Shita. Ndonëse me një shpirt poetik, ju megjithatë në shkollën e mesme u drejtuat në shkencat ekzakte ...?

Po, unë isha me prirje poetike, por njëherësh kisha afinitet të madh për shkencat ekzakte. Matematika ishte lënda ime më e dashur dhe atë falë arsimtares sime të matematikës, zonjës Shita. Por, isha e shkëlqyeshme edhe në lëndët tjera.

Njëherazi kisha vazhduar ta kultivoj poezinë dhe leximin, kështu që edhe në shkollën e mesme isha shumë aktive në grupin letrar të shkollës dhe në aktivitetet tjera letrare jashtë orëve të mësimi. Shkrimet e para i kam botuar në rubrikën për fëmijë të gazetës "Rilindja",



ku redaktor ishin Rexhep Hoxha e Vehbi Kikaj. Kam marrë pjesë edhe në emisionet për fëmijë në Radio Prishtinë, ku redaktor ishte Rrahman Dedaj. E veçanta e kësaj periudhe ishte se kisha kondicion të shkëlqyeshëm fizik, andaj bëja gara në atletikë. Isha e para në garat e shkollave të mesme të kryeqytetit, madje i kaloja edhe meshkujt.

ISHA KUNDËR DALLIMEVE SOCIALE

Në këtë kohë, pra në vitet e shkollimit të mesëm, ka pasur dallime të mëdha midis fshatarëve dhe qytetarëve, vendasve dhe ardhacakëve. Më duhet të them se unë e ndjeja këtë dukuri dhe gjithnjë isha kundër ndasive mbi bazat sociale. Prandaj, u dilja gjithmonë në ndihmë shoqeve dhe shokëve nga fshati. Unë e dija se ata që ishin nga Llapi, Drenica etj. jetonin në kushte jo të mira ekonomike. Ata visheshin me rroba të vjetra, por të pastra. Kjo më shtynte që të shëtisja me ta në qytet, të rrija pranë tyre, gjithnjë duke synuar t’ju ofroja buzëqeshje dhe lumturi. Shpirti im, po ashtu i një vajze të përvuajtur nga historia e rëndë politike e babait dhe e axhës, më jepte kurajo që të qëndroja pranë tyre në të mirë dhe në situata të vështira. Thjeshtë, doja t’i përkrahja, sepse ata sakrifikonin shumë për shkollën. Ata nuk kishin kushte të mira të mësimi dhe të jetës, të banimit, të ushqimit e veshmbathjes si ne të qytetit. Që në këto vite, edhe ne kishim nisur të mendojmë politikisht. Më kujtohet kur dikush nga shokët e klasës e pyeti profesorin se pse rryma nga Kosova transportohet në Serbi, në Hekuranën e Shkupit dhe në viset tjera të ish-Jugosllavisë. Profesori nuk dha përgjigje ...

Në vitin 1966, ra nga pushteti i Aleksandar Rankoviç... Akti i rënies së Rankoviçit e gëzoi mbarë Kosovën sepse ai njihej për veprimet antishqiptare, së bashku me rrjetin e tij policor, por edhe me politikën serbo-jugosllave. U gëzuam edhe familja e jonë sepse pas rënies së tij u shpall një lloj amnistie, andaj babai e axha lirohen nga burgu i Goli Otokut, një nga burgjet më famëkeqe të ish-Jugosllavisë. Por, në burgjet serbo-jugosllave ngelën edhe shumë shqiptarë tjerë dhe ato sërish vazhdonin të mbusheshin me shqiptarë të

tjerë. Ndryshe, unë kujtoj me parafytyrime shumë rrëqethëse vizitën time babait në burgun e Prishtinës. Babanë e kam vizituar edhe në burgun e Pejës. I kujtoj pamjet kur të burgosurit rreshtoheshin në oborr dhe ne të familjes i shikonim së largu, duke mos pasur të drejtë që të afroheshim e të bisedonim, apo qoftë edhe t’ua shtrëngonim duart. Kujtoj çastin shumë prekës, kur motra ime Fëllënza, gjatë një vizite bërë babait në burg, e shpërtheu pengesën dhe vrapoi në përqaftimin e babait. Polici menjëherë vrapoi, e ndau nga babai, kurse ajo e shau policin. E kujtoj edhe vizitën që unë e nëna i bëmë babait në burgun e Nishit dhe mund të them se kur unë isha në këtë burg, asgjë nuk ishte ndryshuar nga koha kur babai im ishte atje.

PASIONI PËR RROBAQEPËSI ...

Axhën tim e kam takuar për herë të parë kur ai u lirua nga burgu dhe asnjëherë më parë, as në fotografi nuk e kisha parë. E kujtoj çastin kur ai erdhi. Dhoma ishte me shumë mysafirë dhe unë pyeta se cili është axha im. Pastaj u afrova dhe e përqafova. Më kishte lënë foshnje dhe tash më gjeti të rritur. Ndryshe, më thoshin se unë i përngjaja atij ... Babai edhe për shumë vite mbeti pa punë, ishte keq me shëndet, andaj gjyshja detyrohej të punonte. Ndërkohë, derisa unë isha brucoshe, ai regjistroi fakultetin juridik dhe e mbaroi. T’ju them të drejtën, edhe ne fëmijët u inspiruam nga studimet e babait dhe qëndresa e tij e jashtëzakonshme.

Ju regjistruat fillimisht stomatologjinë, e pastaj mjekësinë e përgjithshme?

Ju thashë se kisha afinitete të mëdha për shkencat ekzakte, madje edhe për mjeshtri dhe elektrotënikë, sepse këtë zanat ma kishte mësuar babai. Babai im dhe arsimtari i matematikës, Sami Domoni, më sugjeruan që të studioja elektroteknikun, ndërsa unë dëshiroja të regjistroja letërsinë, sepse më flinte në shpirt. Megjithatë, e regjistrova stomatologjinë në Beograd, por shumë shpejt u deprimova, sepse trajtimi ndaj meje si shqiptare nuk ishte i barabartë. Ndërkohë, konkurrova edhe në mjekësinë e përgjithshme. Meqenëse isha në grupin rezervë të studentëve në mjekësinë e përgjithshme, grup

ky i cili u pranua, atëherë i fillova studimet e mjekësisë. Edhe gjatë studimeve, me shoqet e mia shqiptare, ndër të cilat ishte edhe Zana Shita, organizuam një orë letrare. Në këtë kohë, në Fakultetin e Teknologjisë në Beograd studionte edhe motra ime. Në vitin e dytë, për shkak të harxhimeve të mëdha, unë u ktheva dhe vazhdova studimet në Prishtinë. Në këtë kohë, babai ma bleu një biçikletë, për të cilën u gëzova shumë. Pra, këto vite jeta ime përshkohej nga libri, studimet, poezia dhe vozitja e biçikletës.

A kishit ndonjë hobi tjetër?

Po, në këto vite më lindi pasioni për rrobaqepësi dhe sigurisht se kjo vinte nga ndikimi i nënës sime e cila qepte shumë bukur. Gjyshja ime na këshillonte, pavarësisht nga shkollimi, që të merrnim një zanat, sepse jetës nuk i dihet. Gjyshja ime ishte shumë e hollë nga mendja. Në fakt, kjo ishte logjika e të moshuarve, të cilët kishin kaluar jetë të rënda, shpesh duke ngelur pa punë dhe pa asnjë ndihmë ekonomike. Andaj, edhe sot unë di të qep bukur dhe të thur xhemperë e veshje të tjera. Madje, mund të them se kur bëj ndonjë punë dore, ndjem shumë mirë dhe e qetë edhe shpirtërisht.

ÇASTET E LUMTURA ...

Po ta bëje një paralele historike në mes të Flora Brovinës së atyre viteve dhe kësaj të tashmes, si do ta shpjegoje filozofinë jetësore?

Për nga tiparet themelore të filozofisë së personalitetit dhe karakterit tim kujtoj se nuk ka dallime nga ato vite. Unë jam kryesisht ajo që isha edhe atëherë, me karakter të qëndresës ndaj vështirësive në jetë, me ambicie intelektuale dhe kombëtare, duke ditur se për çdo gjë në jetë nevojitet angazhim, sakrificë dhe vetëfljirim. Ndryshe, nuk realizohen ëndrrat e jetës. Ndoshta në poezi dhe letërsi jam mundur të jem më produktive, por duke pasur parasysh se jam marrë me shkencën e mjekësisë dhe pastaj me veprimtari humanitare e nacionale, megjithatë mjaft kam realizuar. Gjithashtu, kam realizuar familjen, që për mua është e shenjtë. Kam realizuar edhe këshillat e gjyshes që të ec vertikalisht, gjithnjë krenare. Edhe në vitet e burgut të babait dhe axhës, unë përpiqesha që para tjerëve të mos tregohesha e dobët, ta fshihja mërzinë. Pra, jeta ime nuk ishte pa brenga, pa sakrifica. Lumturinë e jetës nuk e kam kërkuar në imagjinatën e saj, në skemat dhe spekulimet filozofike ose edhe poetike, por në ballafaqimin me realitetin dhe në fuqinë që të dalë fituese.

A veçon ndonjë çast lumturie?

Nuk mendoj se mund të veçohet ekskluzivisht ndonjë çast lumturie, por, megjithatë, jam ndier shumë e lumtur kur mbaroi lufta. Po ashtu jam ndier e lumtur edhe kur jam bërë nënë në vitin 1977. Ndryshe, më

tepër jam një idealiste se një pragmatiste dhe, megjithatë, mendoj se jetës së njeriut i duhet një lloj filozofie, një lloj idealizimi që të mban edhe kur je keq, edhe kur je e dëshpëruar, edhe kur mendon se po humb. Por, ndjem e lumtur edhe për faktin se kur filluan bombardimet unë vendosa të ngel në Prishtinë, ndonëse mund të largohesha. Unë e ndjeja përkrahjen dhe sigurinë e atyre që i kisha përreth. Ndodhte që brenda natës të përpiqem t’ju ndihmoj më tepër se 100 vetave dhe ajo ishte sfidë që më jepte fuqi morale. Por, edhe kur më arrestuan dhe pastaj kur më burgosën e më dënuan, nuk brengosesha vetëm për jetën time, por për tërë popullin tim.

Flora Brovina: mjeke, humaniste, poete, kandidate për presidente të Kosovës ...

SARMAT DHE TAVAT E MIA JANË TË SHIJSHME

Shpesh mendoj se vokacioni im më i madh dhe më i dashur është poezia dhe se jam lindur me shpirt poetjeje. Humanizmi im buron edhe nga qenia ime shpirtërore, si dhe nga profesioni i mjekësisë. Sa i përket politikës, unë kam pranuar të jem kandidate për president të Kosovës sepse mendoja se edhe ashtu do të jem në shërbim të Kosovës. Prandaj, duke e respektuar propozimin e PDK-së, kam dashur që t’i nderoj vlerat e luftës së UÇK-së, sakrificën më sublime të popullit tim në rrugën e gjatë të lirisë. Vërtet, jam shumë e nderuar që kam qenë kandidate për postin e presidentit. Por, me atë kandidim, unë nuk kam synuar kurrfarë karriere politike!

Si ia arrini të përmbushni gjitha këto obligime ditore?

Së pari punoj shumë dhe me punën time si në shtëpi, pra familje dhe këtu në Qendrën e Fëmijëve dhe të Gruas jam shembull se si duhet punuar me korrektësi dhe pa u ndalur. Unë nuk kam kohë për ndejat e grave. Për punën time kam edhe përkrahjen e familjes. Kur kam kohë, e përgatis ushqimin, por ndodh që edhe bashkëshorti im, i cili është edhe shoku im i jetës, të përgatis ndonjëherë ushqimin. Unë, për shembull, i përgatis shumë mirë sarmat, tavat etj. Ëmbëlsirat i preferoj më pak sepse kohëve të fundit kam shtuar në peshë. Bashkëshorti im di të përgatis disa specialitete më mirë se unë dhe për këtë nuk jam xheloze. Në gjumë shkoj shumë vonë dhe zgjohem me orarin e zakonshëm të punës. Po ashtu, jam duke i përfunduar edhe dy xhemperë të cilët po i thurja që nga koha e bombardimeve, për të kaluar kohën. Njëri ka ngjyrë hiri, për meshkuj dhe tjetri ngjyrë të kuqe, për femra. Po ashtu, vetë e gëlqerosi banesën time dhe kryesisht përdori vetëm ngjyrën e bardhë të cilën e dua. E dua dritën dhe hapësirën sepse kam frikë nga ambientet e mbyllëta, të ngushta dhe të errëta. I dua sidomos lulet ... /Telegrafi/

eg

EURO
GLASS

SAINT-GOBAIN
SEKURIT

PILKINGTON

Enveri

Adr: Fushë Kosovë

Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336

E-mail: euro.glass@live.com

Instalim

Gratifikim

Garancë

Perdor

QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Seferi po udhëheq Kayserisporin drejt Superligës

KAYSERI, 16 SHTATOR - Sulmuesi Taulant Seferi po e udhëheq skuadrën e Kayserisporit drejt rikthimit në Superligën e Turqisë. Pas shtatë xhirove të zhvilluara në Ligën e Parë, Kayserispori prin në tabelë

me 16 pikë, me pesë fitore, një barazim dhe një humbje. E njëri prej më të merituarve për këtë ecuri padyshim se është futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Taulant Seferi. 29-vjeçari ka treguar formë

fantastike, pasi deri më tani ka shënuar shtatë gola në po aq ndeshje kampionale. Seferi është transferuar te Kayserispori gjatë verës nga Bodrumi dhe me ekipin e ri ka kontratë deri në verën e

vitit 2029. Falë formës së tij të mirë, Seferi pritët të jetë në mesin e lojtarëve të grumbulluar nga selektori i Shqipërisë, Rolando Maran, për ndeshjet e Ligës së Kombeve.

DERBI GJILANI - PRISHTINA, TË PREMTEN MBRËMA

PRISHTINË, 16 SHTATOR - Xhiroja e shtatë e Superligës së Kosovës, sikurse edhe xhirot e mëparshme, do të zhvillohet përgjatë tri ditëve, me duelet që do të luhen të premtën, të shtunën dhe të dielën. Megjithatë, kjo xhiro do të hapet me ndeshjen derbi ndërmjet Gjilanit dhe Prishtinës, e cila luhet të

premtën nga ora 19:00, nën dritën e reflektorëve. Kjo është edhe ndeshja më interesante e kësaj xhiroje, duke pasur parasysh formën fantastike të Prishtinës, që i ka fituar të gjitha ndeshjet deri më tani. Prishtina prin në tabelë me 15 pikë, katër më shumë se Gjilani, që zë vendin e katërt

dhe ka një ndeshje më shumë të luajtur se bardhekaltrit. Ndeshjet e tjera të kësaj xhiroje janë Feronikeli '74 - Vushtrria dhe Malisheva - Ballkani, që luhen të shtunën nga ora 16:00. Ndërsa të dielën në orën 16:00 do të përballen Drenica - Llapi dhe Dukagjini - Drita, ndeshje kjo që nis në orën 19:00.

RRON SYLEJMANI, PËRFORCIM I RI I FC DINAMO FERIZAJ

PRISHTINË, 16 SHTATOR - FC Dinamo Ferizaj ka bërë me dije arritjen e marrëveshjes me talentin 20-vjeçar Rron Sylejmani, i cili do t'i bashkohet skuadrës për sezonin e ri. Sylejmani luan në repartin ofensiv, në pozitën e sulmuesit të krahut, duke i shtuar ekipit më shumë alternativa dhe freski në fazën e sulmit. Një kapitull i ri nis në Ferizaj,

ndërsa Sylejmani synon ta shfrytëzojë këtë mundësi për të dëshmuar se potenciali i tij mund të shndërrohet në një emër të rëndësishëm të futbollit të Kosovës. Klubi ferizajas e sheh atë si një futbollist që mund t'i shtojë më shumë alternativa repartit ofensiv, ndërsa për vetë lojtarin kjo është një mundësi e re për t'i treguar cilësitë e tij dhe për ta vazhduar rritjen

profesionale. Me një të kaluar të ndërtuar që nga grupmoshat e reja, statistika pozitive në futbollin senior dhe përvojë në skuadra të ndryshme, Sylejmani synon që në Ferizaj ta bëjë hapin e radhës në karrierën e tij. Dinamo Ferizaj i ka uruar mirëseardhje Rronit dhe shumë suksese në aventurën e tij të re me fanellën e klubit.

SHQIPËRIA ME KATËR MUNGESA TË RËNDËSISHME NË LIGËN E KOMBEVE

TIRANË, 16 SHTATOR - Kombëtarja e Shqipërisë në futboll do t'i ketë disa mungesa për grumbullimin e këtij muaji në kuadër të Ligës së Kombeve. Selektori Rolando Maran gjatë kësaj jave do ta publikojë listën e futbollistëve të ftuar, por do t'i ketë katër mungesa të rëndësishme. Portieri Thomas Strakosha, sulmuesi Myrto Uzuni dhe mbrojtësit Arlind Ajeti e

Marash Kumbulla nuk do të jenë të gatshëm për duelet e Ligës së Kombeve për shkak të lëndimeve. Mungesa e tyre përbën shqetësim për stafin teknik, duke pasur parasysh rëndësinë që këta lojtarë kanë pasur në përbërjen e Shqipërisë gjatë periudhës së fundit. Megjithatë, në listë do të ketë edhe rikthime të rëndësishme, si Rey Manaj

dhe Ernest Muçi, duke i dhënë selektorit Maran alternativa për repartin ofensiv. Maran do ta publikojë listën të premtën, ndërsa të hënën e ardhshme Shqipëria nis grumbullimin për ndeshjet me San Marinon, si dhe për nga një përballje me Bjellorusinë dhe Finlandën. Këto ndeshje do të zhvillohen nga 26 shtatori deri më 6 tetor.

Messi rikthehet tek Argjentina, 6 tetori pritët të jetë lamtumira e tij në “Monumental”

BUENOS AIRES, 16 SHTATOR - Lionel Messi është rikthyer në listën e Kombëtares së Argjentinës, ndërsa 6 tetori pritët të jetë një natë e veçantë për kapitenin në stadiumin “Monumental” të Buenos Airesit. Federata


Argjentinase e Futbollit ka konfirmuar ftesën e Messit për ndeshjet miqësore ndaj Bolivisë, Burkina Fasos dhe Beninit. Pikërisht sfida ndaj Beninit, më 6 tetor, pritët të shërbejë si lamtumira e tij para tifozëve argjentinase. Në

“Monumental” pritët të jenë të pranishëm edhe kampionët e botës nga Katari, së bashku me familjet e tyre. Presidenti i Federatës, Claudio “Chiqui” Tapia, ka deklaruar se Messi “do të ketë lamtumirën që meriton” para

tifozëve të Argjentinës. Messi kishte udhëhequr Argjentinën drejt triumfit në Kupën e Botës 2022, ndërsa tash pritët të përshëndetet me tifozët në një nga stadiumet më ikonike të vendit.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail: contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com



Në bazë të dispozitave të nenit 21, pikës 21.4 të Ligjit nr. 03/L- 087 Për Ndërmarrjet Publike, gjegjësisht nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 17 të Statutit, Bordi i Drejtorëve i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A., me datë 11.09.2026 bazuar mbi Vendimin Nr. 1/2058 publikon këtë:

KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e një (1) pozite

1. Titulli i punës: Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/e Korporativ/e
Vendi: Prishtinë.

Ndërmarrja: N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë.
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve.
Mandati: 3 vite
Koeficienti: 5.9

2. Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Bordi i Drejtorëve, dëshiron të sigurohet që të gjithë kandidatët potencial të jenë persona me integritet të lartë të cilët i plotësojnë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1, (ii) i plotësojnë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2, pikat (d), (f), (j), (k) dhe (l) (iii) nuk janë, ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës tridhjetë e gjashtë (36) muajsh para datës së aplikimit nuk kanë qenë Drejtorë të Bordit të kompanisë gjegjëse dhe (iv) kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar për pozitën në fjalë; Çdo person i cili dëshiron të merret parasysh për një pozitë të drejtorit duhet që po ashtu t'i përmbushë edhe kushtet e përshtatshmërisë profesionale në vijim:

- Të posedojë diplomë universitare -Fakulteti Juridik (jurist i diplomuar ose master në shkenca juridike);
- Të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtës së shoqërive tregtare;
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 neni 13;
- Aftësi për punë ckipore;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Të ketë etikë në punë dhe integritet.
- Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);
- Dëshmitë mbi njohuritë dhe të arriturat tjera do të mirren në konsideratë dhe vlerësohen konform relevancës me vendin e punës;
- Të jetë person me integritet të lartë dhe të plotësojë të gjitha kushtet e përshtatshmërisë të parapara me neni 17 të Ligjit të Ndërmarrjet publike nr. 03/L-087 , dhe plotësim ndryshimet përkatëse,Ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit public nr/06L-011, si dhe me normat tjera positive relevante.

3. Këshilltar/e i/e Përgjithshëm – Sekretar/c Korporativ/e ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- Sigurohet që të përcillen procedurat e Bordit, ku bëjnë pjesë organizimi i takimeve të Bordit, Komiteteve të Bordit dhe Aksionarëve duke përfshirë (në bashkëpunim me Kryesuesin) përgatitjen dhe shpërndarjen e agjendave;
- Mban regjistrin e aksionarëve;
- Koordinon me KE përgatitjen e materialit për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- Mban procesverbalin e mbledhjeve të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit të Auditimit (nëse nuk kërkohet ndryshe nga kryesuesit e tyre) dhe i regjistron në librat e protokolleve;
- Shpërndan procesverbalet tek drejtorët dhe aksionarët;
- Merret me regjistrimin zyrtar të ndryshimeve të cilat kërkohen sipas ligjit, i regjistron në regjistrin e Kosovës për shoqëritë tregtare dhe emrat tregtarë;
- Sipas udhëzimeve nga Kryesuesi, përgjegjësitë e Sekretarit përfshijnë sigurimin e rrjedhjes së mirë të informatave brenda Bordit dhe komiteteve të tij dhe në mes të Bordit dhe menaxherëve të lartë të Ndërmarrjes;
- Këshillat dhe shërbimet e Sekretarit duhet të jenë në dispozicion të të gjithë drejtorëve i cili njëheri është përgjegjës tek Bordi për të siguruar që përputhen procedurat e Bordit;
- Përcjell ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë me ndërmarrjen duke informuar Bordin dhe menaxhmentin e kompanisë për ndryshimet si dhe përgatitë udhëzimet e nevojshme për menaxhmentin e kompanisë.Merret edhe me çështjet tjera të qeverisjes korporative sipas nevojës.

4. Informatë për procedurën e konkurimit

- Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
- Formulari i kërkesës për punësim (aplikimit);
- Kopje e letërnjoftimit; CV ; Çertifikata e lindjes;Letër motivimi;
- Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin profesional e noterizuar;
- Diplomë nga universitetet e huaja duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësit nuk kanë qenë të detyruar të paguajnë në këtë institucion);
- Deklarata nën betim sipas neneve 17.1 dhe 17.2 të Ligjit të NP e cila mundë të shkarkohet nga uebfaqja e Kompanisë;
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

5. Afati i Konkursit:

Konkursi publik është i hapur në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga data 11.09.2026 deri më 10.10.2026

Të interesuarit mund t'i dorëzojnë kërkesat (aplikacionet) e tyre me dokumentet tjera relevante në emailin: burimetnjerezore@pallatirinise.com

Formulari për kërkesë (aplikim) dhe Deklarata nën betim, mund të shkarkohen nga ueb-faqja e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. me seli në Prishtinë në <http://www.pallatirinise.com/> ose mund të merren në zyrat e Ndërmarrjes.

6. Vërejtje:

Kandidatët me dokumentacion të pakompletuar, të paplotësuar dhe jo-adekuat dhe jashtë afatit të konkurimit, do të refuzohen.

Do të kontaktohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe përfshihen në listën e ngushtë.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Sofra e Vushtrris ” SH.P.K. pronar Bajram Bajrami me seli në Vushtri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812229814 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Sofra e Vushtrris” D.O.O. Bajram Bajrami Vuqitern donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812229814 ujedno imenovao Likvidatora o sprovedjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Sofra e Vushtrris” L.L.C. with owner Bajram Bajrami with headquarters Vushtri, has come to the decision to quit its business: 812229814 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail..contact@pallatirinise.com
www.pallatirinise.com

Na osnovu odredbi člana 21, tačke 21.4 Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno člana 13 Zakona br. 04/L-111 o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i na osnovu člana 17 Statuta, Upravni odbor N.P.L. PALATI I RINISE AD, od 11.09.2026. godine, na osnovu Odluke Br. 1/2058 objavljuje ovo:

JAVNI KONKURS

Za popunjavanje jedne (1) pozicije

1. Naziv radnog mesta: Generalni savetnik - Sekretar preduzeća

Lokacija: Priština.

Preduzeće: N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini.

Odgovoran: Upravnom odboru.

Mandat: 3 godine

Koeficijent: 5.9

2. Generalni savetnik - Sekretar preduzeća ima sledeće dužnosti i odgovornosti: Upravni odbor želi da osigura da svi potencijalni kandidati budu osobe visokog integriteta koje ispunjavaju kvalifikacione uslove iz člana 17.1, (ii) ispunjavaju kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k) i (l) (iii) nisu, ili u bilo kom trenutku tokom trideset šest (36) meseci pre datuma podnošenja zahteva nisu bili, direktori Upravnog odbora relevantne kompanije i (iv) imaju neophodno stručno iskustvo i obrazovanje potrebno za predmetnu poziciju; Svako lice koje želi da bude razmatrano za poziciju direktora mora takode ispunjavati sledeće uslove stručne podobnosti:

- Posedovati univerzitetsku diplomu - Pravni fakultet (diplomirani pravnik ili master pravnih nauka);

- Posedovati najmanje pet (5) godina stručnog iskustva u oblasti korporativnog upravljanja ili kompanijskog prava;

- Ispunjavati kvalifikacione uslove iz člana 17.1 i ispunjavati kriterijume nezavisnosti iz člana 17.2, tačke (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima i izmene ZJP br. 04/L-111, član 13;

- Sposobnost za timski rad;
- Posedovati dobre komunikacijske veštine;
- Posedovati radnu etiku i integritet.
- Posedovati računarske veštine;
- Znanje engleskog jezika (poželjno);
- Dokazi o drugim znanjima i dostignućima biće uzeti u obzir i procenjeni u skladu sa relevantnošću za posao;
- Biti osoba sa visokim integritetom i ispunjavati sve uslove podobnosti utvrđene članom 17 Zakona o javnim preduzećima br. 03/L-087 i relevantnim izmenama, Zakonom o sprečavanju sukoba interesa u vršenju javnih funkcija br. 06L-011, kao i drugim relevantnim pozitivnim normama.

3. Generalni savetnik – Sekretar kompanije ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

- Osigurati da se poštuju procedure Odbora, uključujući organizaciju sastanaka Odbora, odbora Odbora i akcionara, uključujući (u saradnji sa predsednikom) pripremu i distribuciju dnevnog reda;
- Voditi registar akcionara;
- Koordinirati sa Izvršnom komisijom pripremu materijala za sastanke Odbora direktora;
- Voditi zapisnike sa sastanaka Odbora direktora i Odbora za reviziju (osim ako njihovi predsednici ne zahtevaju drugačije) i evidentirati ih u zapisnicima;
- Distribuirati zapisnike direktorima i akcionarima;
- Obavljati zvaničnu registraciju promena koje zahteva zakon, evidentirajući ih u Kosovskom registru trgovačkih društava i trgovačkih imena;
- Prema uputstvima predsednika, odgovornosti Sekretara uključuju obezbeđivanje nesmetanog protoka informacija unutar Odbora i njegovih odbora i između Odbora i višeg menadžmenta Kompanije;
- Saveti i usluge Sekretara biće dostupni svim direktorima i biće odgovoran Odboru za obezbeđivanje usklađenosti sa procedurama Odbora;
- Prati pravne promene koje se odnose na Društvo tako što obaveštava Upravni odbor i rukovodstvo Društva o promenama i priprema neophodna uputstva za rukovodstvo Društva. Takođe se bavi i drugim pitanjima korporativnog upravljanja po potrebi.

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;

4. Informacije o postupku konkursa

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za zaposlenje;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih;
- Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome stranih univerziteta moraju biti overene od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije.
- Dokaz o radnom iskustvu/potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, kojom se utvrđuje radno mesto i trajanje angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog fonda za penzijsku štednju, i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili u obavezi da plaćaju ovoj instituciji);
- Izjava pod zakletvom u skladu sa članovima 17.1 i 17.2 Zakona o JP koja se može preuzeti sa veb stranice Kompanije;
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starija od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak podnetih dokumenata.

5. Rok za konkurs:

Javni konkurs je otvoren u periodu od 30 (trideset) dana od 11.09.2026 do 10.10.2026. Zainteresovana lica mogu podneti svoje prijave sa ostalom relevantnom dokumentacijom na imejl adresu: burimetnjerezore@pallatirinise.com Obrazac za prijavu i izjava pod zakletvom mogu se preuzeti sa veb stranice N.P.L. PALATI I RINISE AD sa sedištem u Prištini na <http://www.pallatirinise.com/> ili se mogu dobiti u kancelarijama Kompanije.

6. Napomena:

Kandidati sa nepotpunom, nekompletnom i neadekvatnom dokumentacijom i van roka za konkurs biće odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju navedene kriterijume i koji su uvršteni u uži izbor.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, “Lab -Oil” shpk., Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor për projektin “Sistem Solar Fotovoltaik me kapacitet 375 kW mbi objektin me leje ndërtimore.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.11.2026 në ora 10:00 Kuvendin komunal të Graçanicës, do të organizohet debat publik nga “Lab -Oil” shpk., Graçanicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68pjZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për “Lab -Oil” shpk., Graçanicë, për Pëlqim Mjedisor për projektin “Sistem Solar Fotovoltaik me kapacitet 375 kW mbi objektin me leje ndërtimore

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnk.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.





ROYAL CROWN

RC

cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



RC

cola

Columbus, Georgia, USA

Since 1906

Columbus, Georgia, USA

Since 1906

0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

